



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional  
“Auditim i Brendshëm dhe Kontroll Financiar”  
i  
Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Mesdhetar  
i Shqipërisë”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:


1. Prof As. Rezarta Shkurti Perri
2. Prof As. Gentiana Sharku

Shtator/2022



**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**  
**Për Programin e studimit Master Profesional në “Auditim i Brendshëm dhe Kontrolli Financiar” ofruar nga Institucioni i Arsimit të lartë Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Financë Bankë dhe Kontabilitet
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional “Auditim i Brendshëm dhe Kontroll Financiar”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 346 datë 17.09.2021
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit/2 Semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
11	Forma e studimit:	Kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	6 PAE/ 0 PAK v.a. 2021-2022
18	Numri i studentëve:	29 Studentë v.a 2021-2022
19	Komente / të tjera:	-






## PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM TE PROGRAMIT

Programi i ciklit të dytë të studimit Master Profesional në “Auditim i Brendshëm dhe Kontroll Financiar”, është hapur me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 346, datë 17.09.2021. Ky program mbulohet nga Departamenti Financë Bankë dhe Kontabilitet, në Fakultetin e Shkencave Ekonomike, të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, të liçencuar me VKM Nr. 177, datë 19.02.2009 dhe i akredituar me vendim të Bordit të Administrimit Nr. 62, datë 18.12.2020.

Programi Master Profesional në “Auditim i Brendshëm dhe Kontroll Financiar”, është emërtuar dhe organizuar në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të njësisë kryesore të institucionit të arsimit të lartë, si pjesë e sferës së financës dhe kontabilitetit. Përsa i përket strukturës dhe organizimit ky master është i organizuar në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “*Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL*”, sipas të cilit lëndët ndahen në lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore / integruese, lëndë plotësuese dhe detyrime përmbyllëse.

Programi i studimit realizohet me 60 kredite (ECTS), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 1 vit akademik (2 semestra), në përfundim të të cilit studentët pajisen me diplomë të ciklit të dytë të studimeve “Master Profesional në Auditim të Brendshëm dhe Kontroll Financiar”.

Objektivi kryesor i këtij programi është formimi i ekspertëve dhe specialistëve në aspektet teorike, praktike dhe aplikative në fushën e auditimit të brendshëm dhe kontrollit financiar. Dhënia e dijeve dhe aftësive profesionale si edhe përcimi i formimit praktik të studentëve deri në përfundim të programit të studimit, sic evidentohen në Planin Mësimor të Programit të studimit paraqiten në përputhje me studimet e nivelit master profesional, dhe mundësojnë që studentët të formohen konform kërkesave dhe nevojave të tregut të punës. Programi Master Profesional në “Auditim i Brendshëm dhe Kontroll Financiar” është hapur në vitin 2021 dhe për vitin akademik 2021 – 2022, në këtë program janë regjistruar 29 studentë.





## Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm; 200 fjalë

Në datën 15.12.2021, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka dorëzuar pranë ASCAL formularin e aplikimit për akreditimin e programit Master Profesional në "Auditim i Brendshëm dhe Kontroll Financiar" me profile nëpërmjet shërbimit në AMS. ASCAL bazuar në "Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017" ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UMSH, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Prof. Asoc. Dr. Gentiana Sharku, pedagoge në FEUT, Departamenti i Financës, dhe Prof. Asoc. Dr. Rezarta Shkurti, pedagoge FEUT, Departamenti i Kontabilitetit. Gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxheri teknike e ASCAL, Znj. Aviola Bardhi.

Në datën 04.05.2022, ekspertëve të jashtëm iu vendos në dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësim. Pas një kohe në dispozicion të ekspertëve për të studiuar dokumentat dhe për të përpiluar pyetjet apo paqartësitë e tyre, u përcaktua edhe agenda e vizitës në institucion, e cila u zhvillua në datën 07.06.2022 në ambjentet e UMSH. Gjatë vizitave ekspertëve iu vendos në dispozicion një sallë mbledhjesh për të kryer të gjitha takimet sipas agjendës së planifikuar. Dokumentacioni shtesë i kërkuar nga ekspertët u vu në dispozicion në datën 15.06.2022.

Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit dhe intervistave me pyetje të përcaktuara të ekspertëve, GVJ paraqet si më poshtë vlerësimin e tij sipas standarteve dhe për çdo kriter që i referohet standartit për programin e studimit MP në "Auditim i Brendshëm dhe Kontroll Financiar". Në fund paraqiten rekomandimet për institucionin dhe kryhet një analizë SWOT mbi programin e studimit që akreditohet. Ky raport është përpiluar në bashkëpunim midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.


GVJ shqyrtoi komentet e bëra nga Institucioni lidhur me draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm dërguar me datë 27.07.2022 dhe konkretisht konstatoi si më poshtë:

1. Lidhur me *Standardin IV.5, kriteri 6*, GVJ është shprehur plotësisht mbi çfarë ka konstatuar gjatë shqyrtimit të dokumentacionit dhe nga vizita në institucion. GVJ në raport është shprehur mbi çfarë ka konstatuar gjatë vëzhgimit të faqes së internetit të Institucionit, konstatim i cili është bërë i ditur edhe gjatë vizitës në institucion. GVJ në raport është shprehur edhe mbi përgjigjen e institucionit që faqja e internetit është në proces riorganizimi.
2. Lidhur me *Standardin IV.6, kriteri 1*, kriteri kërkon hartimin e një plani financimi për programin e studimit dhe jo për institucionin. Në dijeninë tonë një plan financimi i tillë është i detyrueshëm të bëhet të paktën kur aplikohet për licencimin e programit të studimit.
3. Lidhur me *Standardin IV.6, kriteri 2*, GVJ ka komentuar shifrat sipas faktit, jo programit të shpenzimeve.
4. Lidhur me *Standardin IV.6, kriteri 5*, GVJ ka komentuar që nuk mund të shprehet mbi qëndrueshmërinë financiare të institucionit në bazë të dokumentacionit mbështetës të RVB. Ky nuk është një tagër e GVJ, por konstatohet nga raporti i



audituesit të jashtëm, i cili i vihet në dispozicion GVJ. Por megjithatë GVJ e ka kërkuar gjatë vizitës, dhe ky dokument nuk i është vënë në dispozicion nga institucioni.

5. Lidhur me *Standardin VI.2, kriteri 3*, GVJ është shprehur mbi një mospërputhje që ka konstatuar midis dokumentacionit mbështetës të RVB-së dhe takimit me studentët e këtij programi.
6. Lidhur me *Standardin IV.6, kriteri 5*, GVJ është shprehur mbi mospërputhjen që ekziston midis procedurës së përshkruar në aktet rregullatore të institucionit dhe praktikës që zbatohet nga NJSBCZHK, e cila përshkruhet edhe në komentin e institucionit. Në këtë drejtim, ka nevojë që të rishikohen detyrat dhe përgjegjësitë NJSBCZHK në Manualin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.
7. Lidhur me *Standardin IV.6.3, kriteri 1*, GVJ nuk ka koment meqë institucioni e pranon që nuk ka kryer një analizë për këtë program studimi meqënëse nuk është mbyllur një vit i plotë akademik.
8. Lidhur me *Standardin IV.6.4, kriteri 1*, GVJ ka konstatuar se institucioni nuk ka ekspertë të jashtëm të angazhuar formalisht dhe drejtëpërdrejt në NJSBCZHK. Angazhimi në formë dhe menyrë të tjera i ekspertëve të jashtëm, sikurse sqarohet në komente nga institucioni, nuk është shprehur as në RVB dhe as gjatë takimit të institucionit.





**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional**  
**“Auditim i Brendshëm dhe Kontrolli Financiar”**

**I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë “Master profesional” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Grupi i vlerësimit të jashtëm (në vazhdim, GVJ) shqyrtoi përmbajtjen e dokumentave që janë pjesë e Dosjes së Vetë Vlerësimit (në vazhdim, DVV) për të gjykuar mbi shkallën e përmbushjes së kriterit 1. Sipas Statutit të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë (UMSH), neni 4, pika 1, vizioni i këtij institucioni është: “krijimi i një institucioni cilësor të arsimit të lartë, i cili ofron vlera të vërteta qytetarie dhe profesionalizmi; nëpërmjet një edukimi ndërdisiplinor të përgatisë qytetarë të angazhuar dhe me integritet në një mjedis social aktiv dhe në përputhje me interesat kombëtare”. Po kështu në Statutin e Institucionit, (neni 4, pika 2, paragrafi 5) thekson se Institucioni ka si mision “të kontribuojë në mbështetjen e prioriteteve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit”. Mbështetur në këto dy referenca, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, GVJ gjykon se Institucioni e përmbush kriterin.  <u>Evidenca 1. Statuti i UMSH.pdf</u>
<b>Kriteri 2</b> Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Misioni i Institucionit, sipas Planit Strategjik të zhvillimit të UMSH është ofrimi i një edukimi cilësor të qëndrueshëm, dhe që t’i shërbejë dijes së shoqërisë shqiptare me anë të kontributit në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, përdorimit të arritjeve më të mira dhe partneriteteve me tregun e punës dhe atyre ndërkombëtare. Instrumente për arritjen e misionit të institucionit, sipas Planit strategjik të zhvillimit, janë ndër të tjera edhe arritja e ekselencës në fushën akademike dhe ndërtimi i urave të bashkëpunimit kombëtar dhe rajonal duke demonstruar qëllimin e ruajtjes së vlerave të krjuara në shoqërinë tonë.  GVJ duke gjykuar nga elementet e përfshira në misionin e Institucionit, dhe instrumentet e parashikuara për arritjen e tij, gjykon se në tërësi programet e studimit të ofruara nga UMSH synojnë ruajtjen e traditave dhe vlerave kombëtare.  <u>Evidenca 1. Statuti i UMSH.pdf</u> <u>Evidenca 2. Plani strategjik i zhvillimit UMSH.pdf</u>
<b>Kriteri 3</b> Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Sipas nenit 4, pika 2 të Statutit të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, misioni i këtij institucioni përfshin disa elemente si: “ofrimin e arsimit të lartë dhe veprimtarisë krijuese në shkencat ekonomike, juridike, marrëdhënieve ndërkombëtare, psikologjike, sociale dhe politike që realizojnë synimet e tyre profesionale brenda dhe jashtë vendit në




	<p>përputhje me kërkesat dhe nevojat e shoqërisë”; “zhvillimin dhe mbrojtjen e dijeve nëpërmjet mësimdhënies dhe veprimtarisë akademike që kryhet brenda dhe jashtë vendit”; “formimin e studiuesve të rinj në fushat e shkencave ekonomike, juridike, marrëdhënieve ndërkombëtare, psikologjike, sociale dhe politike nëpërmjet programeve universitare të një niveli të përparuar e bashkëkohor teorik, metodik e praktik”; “thellimin e kualifikimit profesional e shkencor të specialistit të lartë duke ofruar mundësi të mira për të përfituar nga arsimi i lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës”; “të kontribuojë në mbështetjen e prioriteteve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit”.</p> <p>Qëllime të UMSH (Statuti i UMSH, neni 5, pika 1), janë ofrimi i studimeve universitare në cikle të ndryshme dhe mësimi gjatë gjithë jetës. UMSH angazhohet në promovimin, organizimin dhe realizimin e shërbimeve kulturore e formuese kombëtare (Statuti i UMSH, neni 5, pika 3) të cilat konservojnë vlerat shqiptare në këto fusha.</p> <p>Fushat e veprimtarisë së Institucionit janë ofrimi i programeve të studimit në fushat <i>ekonomike, juridike sociale dhe politike</i>. Konkretisht, programi i studimit Master Profesional në Auditim të Brendshëm dhe Kontroll Financiar paraqitet në përmbushje të realizimit të misionit të plotë të institucionit, dhe vjen në përputhje me fushën e veprimtarisë së tij.</p> <p><u>Evidenca 1. Statuti i UMSH.pdf</u>  <u>Evidenca 2. Plani strategjik i zhvillimit UMSH.pdf</u>  <u>Evidenca 3. Strategjia e zhvillimit te programit MPABKF.pdf</u></p>								
<p><b>Kriteri 4</b> Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Referuar Strategjisë së zhvillimit të programit të studimit Master Profesional në Auditim të Brendshëm dhe Kontroll Financiar (në vazhdim, MPABKF) GVJ informohet se misioni i këtij programi është pajisja e studentëve me një sistem të ndërlidhur njohurish që i formon ata në fushën e financës, kontabilitetit dhe auditimit, dhe i aftëson ata për aplikimin e tyre në sektorin privat, publik dhe atë jo fitimprurës. Si synim më specifik i programit të studimit përmendet përgatitja e specialistëve dhe kërkuesve profesionistë në fushën e auditimit të brendshëm me njohuritë e nevojshme dhe aftësitë e duhura në trajtimin e situatave dhe vendimmarrje me profesionalizëm, integritet dhe aftësi inovatore. Nga vizita e GVJ në Institucion u konstatua se hapja e programit të studimit ka marrë shkas nga kërkesa e konstatuar nga specialistët e fushës të cilët e shohin programin e studimit si një mënyrë për të plotësuar sfondin e tyre akademiko praktik.</p> <p><u>Evidenca 3. Strategjia e zhvillimit te programit MPABKF.pdf</u></p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="592 1697 746 1765">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="746 1697 963 1765">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="963 1697 1177 1765">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1177 1697 1394 1765">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="592 1765 746 1814"></td> <td data-bbox="746 1765 963 1814"></td> <td data-bbox="963 1765 1177 1814"></td> <td data-bbox="1177 1765 1394 1814" style="text-align: center;"><b>X</b></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				<b>X</b>
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			<b>X</b>						

**Standardi I.2**

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al


Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)





**Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Dy dokumentat bazë që u shqyrtuan nga GVJ për të analizuar përmbushjen e këtij kriteri ishin Plani Strategjik i zhvillimit të UMSH, 2018 – 2023 dhe Strategjia e zhvillimit të programit të studimit MPABKF 2021 – 2025. Plani strategjik i UMSH, deklaroi që në krye qëllimin për të qenë në mbështetje të prioritetëve strategjike të Shqipërisë: Mësimdhënie cilësore, Dije të qëndrueshme, Bashkëpunim, kërkim shkencor dhe Inovacion. Në pikën IV në strategjinë e zhvillimit të programit të studimit specifikohen qartë misioni, qëllimi, dhe objektivat si edhe konfirmohet përputhshmëria me strategjinë e zhvillimit të institucionit.</p> <p><u>Evidenca 2. Plani strategjik i zhvillimit UMSH.pdf</u>  <u>Evidenca 3. Strategjia e zhvillimit të programit MPABKF.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Statuti i UMSH në rolin e një prej dokumenteve themeltare të rregullimit të funksionimit brendshëm të Institucionit është i qartë në identifikimin e drejtimeve prioritar akademike të tij: (neni 4, pika 2, a) “ofrimi i arsimit të lartë dhe veprimtarisë krijuese në shkencat ekonomike, juridike, marrëdhënies ndërkombëtare, psikologjike, sociale dhe politike që realizojnë synimet e tyre profesionale brenda dhe jashtë vendit në përputhje me kërkesat dhe nevojat e shoqërisë”.</p> <p>Në përputhje me këto drejtime prioritar akademike, në nenin 10, pika 3 të Rregullores së organizimit të UMSH përcaktohet edhe organizimi i Institucionit në tre fakultete të cilat përkohet me një mbulim tërësor të këtyre drejtimeve prioritar akademike: Fakulteti i Shkencave Ekonomike; Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënies Ndërkombëtare; Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike. GVJ konfirmon se programi i studimit Master Profesional në Auditim të Brendshëm dhe Kontroll Financiar ofrohet në përputhje me një nga drejtimit prioritar të institucionit.</p> <p><u>Evidenca 2. Plani strategjik i zhvillimit UMSH.pdf</u>  <u>Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Duke qenë se drejtimit akademike të institucionit janë fushat: ekonomike, juridike, marrëdhënies ndërkombëtare, psikologjike, sociale dhe politike, Programi i Studimit Master Profesional në Auditim të Brendshëm dhe Kontroll Financiar paraqitet i emërtuar, i organizuar dhe i strukturuar në përputhje me të paktën një nga fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.</p>	<p>Referuar në përgjithësi dokumentacionit të dorëzuar në Dosjen e VetëVlerësimit (DVV) si edhe mbështetur në diskutimet gjatë vizitës në Institucion, GVJ vuri re se programi ishte konceptuar si një përgjigje ndaj nevojave të tregut për specialistë të auditimit të brendshëm dhe kontrollit financiar. Kjo është edhe në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit të ekonomisë shqiptare, me synimin për të ndërthur legjisllacion vendas në përputhje me kërkesat e BE, si edhe në</p>





	përputhje me edukimin në vend dhe sipas ecurisë së trendeve globale të zhvillimit në botë.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi I.3

**Programet e studimit “Master profesional” synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit “Master profesional” kanë objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Referuar Rregullores së programit të studimit GVJ konstaton se për këtë program studimi specifikohen qartë objektivat për formimin e studentëve në nenin 4 të saj. (1) formimi i ekspertëve dhe specialistëve të mirëfilltë në fushën e auditimit të brendshëm dhe kontrollit financiar; (2) formimi teorik dhe praktik i studentëve në fushat e strategjive të kontrollit financiar dhe auditimit.</p> <p>Dhënia e dijeve dhe aftësive profesionale si edhe përcimi i formimit praktik të studentëve deri në përfundim të programit të studimit, sic evidentohen në Planin Mësimor të Programit të studimit paraqiten në përputhje me studimet e nivelit master profesional, dhe mundësojnë që studentët të formohen konform kërkesave dhe nevojave të tregut të punës.</p> <p><u>Evidenca 7. Rregullore e programit MPABKF.pdf</u>  <u>Evidenca 8. Plan mesimor dhe syllabuse MPABKF.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV, u konstatua një studim i tregut të punës për degët që i korrespondojnë Fakultetit të Shkencave Ekonomike për periudhën 2019 – 2022. Ky studim nuk lidhet specifikisht vetëm me programin e studimit, megjithatë paraqet tipare të një studimi të plotë dhe të argumentuar për të gjitha drejtimet e programeve ekonomike.</p> <p>Studime pas daljes së studentëve nuk ka pasi ky është një program që është hapur në vitin 2021 dhe nuk ka ende studentë të diplomuar. Komunikime me punëdhënësit e fushës konstatohet që ekzistojnë, pasi Institucioni ofron evidencë për një larmi marrëveshesh bashkëpunimi me Institucione të tjera.</p> <p><u>Evidenca 9. Analiza e tregut te punes FSHE.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i përmbajtjes së programit të studimit GVJ konstaton se objektivat formuese dhe struktura e programit të studimit MPABKF orientohen kah nevojave të konstatuara në tregun e punës sipas kërimit përkatës. Objektivat për formimin e studentëve në nenin 4 të saj cilësohen të jenë: (1) formimi i ekspertëve dhe specialistëve të mirëfilltë në fushën e auditimit të brendshëm dhe kontrollit financiar; (2) formimi teorik dhe praktik i studentëve në fushat e strategjive të kontrollit financiar dhe auditimit. Në përfundim të studimeve ky program u mundëson studentëve të</p>



	<p>punësohen kryesisht si auditues të brendshëm në sektorë të ndryshëm, si institucione financiare, sektori publik, etj.</p> <p><u>Evidenca 7. Rregullore e programit MPABKF.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Referuar përmbajtjes së programit të studimit, në dijeninë e GVJ ky program paraqitet kryesisht i ngjashëm me programe që ofrohen nga institucione analoge brenda dhe jashtë vendit në këtë fushë. Ngjashmëria është në shkallë të tillë që lehtëson qoftë transferimin e studimeve në programe të ngjashme brenda dhe jashtë vendit, qoftë punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar.</p> <p><u>Evidenca 8. Plan mesimor dhe syllabuse MPABKF.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikat e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të DVV programi MPABKF paraqitet në përgjithësi i hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë, si Ligji Për Arsimin e Lartë, Korniza Shqiptare e Kualifikimeve dhe Karta e Bolonjës. Programi i studimit ofrohet në një Institucion i cili ka mbi 10 vite që ofron programe studimi në fushën ekonomike në vendin tonë duke ofruar një sfond të pasur për eksperiencën në këtë disiplinë.</p> <p><u>Evidenca 7. Rregullore e programit MPABKF.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e ciklit të dytë “Master profesional” përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Referuar RVB informohemi se Institucioni ka përfshirë praktikën profesionale si një lëndë të detyrueshme në Planin Mësimor të programit të studimit MPABKF cka konstatohet edhe nga evidencat në DVV. Praktika zhvillohet në semestrin e fundit dhe ka gjithsej 6 (gjashtë) kredite. (Meqënëse pothuaj të gjithë studentët e këtij programi studimi u konfirmua që janë të punësuar në pozicione të ndryshme finance apo kontabiliteti, ata kishin pasur mundësinë që të zhvillonin praktikat profesionale pranë pozicioneve respektive të punës).</p> <p>Gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstatoi se përgjegjësit e njësisë kryesore dhe njësisë bazë që ofron programin e studimit konfirmuan marrjen parasysh të kuadrit ligjor rregullues të profesionit të auditimit të brendshëm në vend dhe në botë, sidomos të auditimit të brendshëm dhe kontrollit financiar në sektorin publik.</p> <p><u>Evidenca 8. Plan mesimor dhe syllabuse MPABKF.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.</p>	<p>GVJ konstatoi se programi i studimit MPABKF ofrohet në gjuhën shqipe. Elemente të literaturës me zgjedhje në programet lëndore paraqiteshin në mënyrë sporadike në gjuhë të huaj, kryesisht atë angleze, dhe kjo konsiderohet pozitive nga ana e GVJ për shkak të pasurisë së literaturës në këtë gjuhë dhe aksesit që ofron për studentët.</p> <p><u>Evidenca 7. Rregullore e programit MPABKF.pdf</u> <u>Evidenca 8. Plan mesimor dhe syllabuse MPABKF.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësimin të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar.</p>	<p>RVB për këtë kriter shprehet negativisht pasi qëllimi i këtij programi studimi nuk është i përkohshëm. Gjithashtu, në këndvështrimin dhe formimin e GVJ, ky program studimi pritet të ketë një natyrë më afatgjatë (pra të mos jetë i përkohshëm), dhënë kërkesën e</p>





	vazhdueshme që tregu ka për profesionistë të formuar në fushën e auditimit dhe kontrollit financiar.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.4</b>	
<b>Programet e ciklit të dytë “Master profesional” janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit MPABKF është Fakulteti i Shkencave Ekonomike, ndërsa njësia bazë përgjegjëse është Departamenti i Financë Bankë Kontabilitetit. Nga shqyrtimi i tabelave në anekset e RVB, GVJ konstaton se Institucioni disponon staf akademik të mjaftueshëm dhe të formuar në mënyrë të përshtatshme për ofrimin e programit të studimit në këtë fushë. Gjithashtu GVJ gjykon se në tërësi burimet infrastrukurore janë të mjaftueshme për mbulimin e nevojave të programit të studimit.  <u>Evidenca 10. Permbledhese e tabelave per programin MPABKF (1 deri 24).pdf</u>
<b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programi i studimit MPABKF, është program studimi i ciklit të dytë të studimit, referuar nivelit të 7 të kornizës Shqiptare të Kualifikimeve; organizohet me 60 kredite evropiane dhe kohëzgjatje normale një vit akademik me kohë të plotë, në përputhje me kërkesat e Ligjit 80/2015.  Ky është një program i fushës së shkencave ekonomike i cili ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Ekonomike. GVJ gjykon se ka përputhshmëri mes fushës së përgjithshme dhe specifike të programit të studimit dhe fushës akademike e kërkimore të njësisë kryesore që është përgjegjëse për ofrimin e programit (Fakulteti i Shkencave Ekonomike). Ndërsa njësia bazë që është përgjegjëse për ofrimin e këtij programi studimi është Departamenti i Financë, Bankë, Kontabilitetit dhe GVJ edhe këtu konstaton përputhshmëri të profilit akademik dhe kërkimor mes njësisë bazë dhe programit të studimit.  <u>Evidenca 7. Rregullore e programit MPABKF.pdf</u>
<b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Njësia bazë që është përgjegjëse për ofrimin e këtij programi studimi është Departamenti i Financë, Bankë, Kontabilitetit dhe GVJ edhe këtu konstaton përputhshmëri të profilit akademik dhe kërkimor mes njësisë bazë dhe programit të studimit.  Në rastin e programit të studimit MPABKF, ai nuk është një program ndërdisiplinor ndaj kjo pjesë e kriterit nuk aplikohet.  <u>Evidenca 7. Rregullore e programit MPABKF.pdf</u>



<b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi pasi në kriteret më lart GVJ ka konstatuar përputhshmëri të plotë.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Nga analiza e përmbajtjes së DVV, GVJ ndeshi evidencë për ekzistencën e procedurave si edhe për ndarjen e detyrave mes njësisë përgjegjëse kryesore dhe asaj bazë, ndarjen e përgjegjësiwe mes personelit të angazhuar për programin e studimit dhe kryerjen e analizës së vazhdueshme të punës së tyre. Institucioni ka hartuar rregullore të funksionimit të njërive kryesore dhe bazë, ku detajohet cdo aspekt i nevojshëm si detyra, role, funksione, etj. Shihet gjithashtu se është bërë një parashikim i detajuar dhe i kujdesshëm i rolit të përgjegjësit të njësisë bazë, dhe koordinatorit të programit sikurse dhe ato të titullarit të lëndëve specifike.  <u>Evidenca 1. Statuti i UMSH.pdf</u> <u>Evidenca 4. Rregullore e organizimit te UMSH.pdf</u> <u>Evidenca 5. Rregullore e FSHE.pdf</u> <u>Evidenca 6. Rregullore e DFBK.pdf</u>
<b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	Në tabelën 5 të anekseve të RVB, Institucioni ka listuar rreth 25 marrëveshje bashkëpunimi në kuadër të ofrimit të studimeve në programin MPABKF. Duke qenë marrëveshje me partnerë nga bota e biznesit, autoritete ose ente shtetërore si edhe grupe bankare të njohura ndërkombëtare me prezencë, seli dhe aktivitet në vendin tonë, GVJ është e mendimit se marrëveshjet ndihmojnë ndjeshëm Institucionin në arritjen e objektivave të procesit mësimor për këtë program studimi.  <u>Evidenca 10. Permbledhese e tabelave per programin MPABKF (1 deri 24).pdf</u>
<b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programeve të ciklit të dytë “Master profesional”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	GVJ hasi disa marrëveshje bashkëpunimi në favor të ofrimit të programit të studimit MPABKF. Gjithashtu Institucioni ka analizuar efektet e marrëveshjeve dhe reflektimin e përfuar nga këto marrëdhënie në një raport të posacëm ku reflektohen nevojat e të dyja palëve, Institucionit dhe punëdhënësve të fushës përkatëse. <u>Evidenca 10. Permbledhese e tabelave per programin MPABKF (1 deri 24).pdf</u> <u>Evidenca 15. Memo mbi bashkëpunimin me bizneset.pdf</u>





<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron.	Sic GVJ konstatoi edhe në kriteret më lart, UMSH paraqitet si Institucion me një gamë të gjerë marrëveshjesh bashkëpunimi me një larmi institucionesh dhe partnerësh. Të pyetur gjatë vizitës në Institucion në lidhje me praktikat specifike të këtij programi studimi, GVJ u informua se pothuajse të gjithë studentët e programit ishin të punësuar dhe i kanë kryer praktikat pranë pozicioneve përkatëse të punës. Gjatë këtij procesi, studentët konfirmuan se ishin asistuar nga pedagogët e njësisë bazë që ofron programin e studimit, përsa i përket dokumentacionit që duhet të dorëzonin dhe mënyrave të shlyerjes së lëndës së praktikës profesionale.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Në RVB për këtë kriter, Institucioni konfirmon qëllimin e tij për të qëndruar sa më afër nevojave të studentëve edhe pasi ata dalin në profesion, por në lidhje me këtë program studimi ky kriter nuk mund të aplikohet ende pasi në momentin e aplikimit për akreditim të programit (maj 2022), akoma nuk ka studentë të diplomuar në këtë program.			
<b>Kriteri 6.</b> Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Për këtë kriter në RVB e përgatitur nga Institucioni deklarohet se UMSH analizon rregullisht marrëveshjet e bashkëpunimit për të evidentuar përfitimet në funksion të realizimit të objektivave të programit të studimit. Gjatë punës GVJ ndeshi një material analitik në të cilin bëhej analiza e marrëveshjeve të bashkëpunimit kryesisht me botën e biznesit. <u>Evidenca 15. Memo mbi bashkëpunimin me bizneset.pdf</u>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			3	<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL

<b>Standardi II.1 Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian	Nga shqyrtimi i Planit Mësimor të Programit të Studimit MPABKF në UMSH, GVJ konstaton se programet e studimit janë të organizuara në lëndë dhe module, të detyrueshme dhe me zgjedhje dhe të vlerësuara me kredite mësimore sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Gjithsej ky program studimi ka në



<p>të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>total 60 ECTS dhe është i organizuar në harmoni me kërkesat e ligjit për arsimin e lartë Nr. 80/2015.</p> <p>GVJ konstaton se disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në programin e studimit janë të organizuara në 5 kategori, nga A në E, në përputhje me VKM nr. 41 të ndryshuar me VKM nr 879. Disiplinat mësimore të ofruara në kategoritë A, B, C, D dhe E janë të ndërthurura, të detyrueshme dhe me zgjedhje dhe vlerësohen me kredite. (Sipas VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar, në kategorinë A bëjnë pjesë disiplina të formimit të përgjithshëm për përgatitje metodologjike dhe kulturë të përgjithshme; në kategorinë B, që janë lëndët bazë, përfshihen disiplina të formimit karakterizues të programit për përgatitje shkencore; në kategorinë C përfshihen lëndë ndërdisiplinore, profile dhe grup-lëndësh me zgjedhje; në kategorinë D përfshihen lëndët plotësuese si dhe praktika profesionale. Ndërsa në kategorinë E janë detyrimet përmbyllëse për diplomim.)</p> <p><u>Evidenca 8. Plan mesimor dhe syllabuse MPABKF.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>I shprehur në Strategjinë e programit të studimit MPABKF në UMSH, misioni i këtij programi është përgatitja e specialistëve të fushës së financës, kontabilitetit dhe auditimit, duke u ofruar atyre një sistem të ndërlidhur njohurish.</p> <p>Nga shqyrtimi i Planit Mësimor të Programit të Studimit, GVJ konstaton se ky program studimi përveçse përmban lëndë të detyrueshme dhe me zgjedhje, ofron mundësinë që studentët të angazhohen dhe në module studimi më të fokusuar brenda lëndëve të caktuara sic është p.sh., lënda e Auditimit të Brendshëm dhe Kodit të Etikës. Ka gjithashtu lëndë që mbulojnë financën, kontabilitetin, auditimin, elemente formuese në fushën e teknologjisë së informacionit dhe kulturës digjitale, që në gjykimin e GVJ ofrojnë në përgjithësi një formim të larmishëm dhe të pasur shumëdisiplinor për studentët.</p> <p><u>Evidenca 3. Strategjia e zhvillimit të programit MPABKF.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 8. Plan mesimor dhe syllabuse MPABKF.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Nga analiza që GVJ i bëri tërësisë së programeve lëndore të programit të studimit, konstatohet se ky program ofron për studentët mbulim kryesisht të mjaftueshëm të një larmie njohurish teknike në fushat e auditimit dhe financës, si edhe anon drejt përgatitjes së profesionistëve me ndërthurje të parimeve akademike dhe njohurive praktike të disiplinës së auditimit. Sic u theksua gjatë vizitës në Institucion, fokusi i pedagogëve ishte orientimi i studentëve drejt praktikës më shumë sesa teorisë.</p> <p><u>Evidenca 8. Plan mesimor dhe syllabuse MPABKF.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 4</b> Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Bazuar më së shumti në analizën që GVJ i bëri dosjes së syllabuseve të lëndëve të programit, por edhe në diskutimet e kryera gjatë vizitës në Institucion me pedagogët dhe studentët e programit të studimit, GVJ, në kuadrin e njohjes dhe eksperiencës së vet, formoi përshtypjen se gama e lëndëve të ofruara në këtë program studimi si edhe përmbajtja e syllabuseve të tyre mundësojnë ndërthurjen dhe integrimin e njohurive në mënyrë të tillë që, nga ana teknike, studentët të aftësohen e të përgatiten për problem zgjidhje në situata mesatarisht komplekse. Vetë studentët u</p>



	shprehën konfidentë për plotësinë e njohurive të marra prej tyre gjatë studimeve. <a href="#">Evidenca 8. Plan mesimor dhe syllabuse MPABKF.pdf</a>			
<b>Kriteri 5</b> Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Nga shqyrtimi i DVV, GVJ konstaton se programi i studimit MPABKF në UMSH ofrohet me 60 ECTS, me kohëzgjatje normale 1 vit akademik. Studimet përfshijnë praktikë të detyrueshme profesionale 6 ECTS dhe përmbillen me provim përfundimtar formimi, ose punim diplome me 8 ECTS. Në përfundim të studimeve lëshohet diplomë "Master profesional". Në lidhje me këto elemente pra, ky program është i konfiguruar në përputhje me kërkesat e ligjit për arsimin e lartë Nr. 80/2015, (neni 75, pika 6). <a href="#">Evidenca 7. Rregullore e programit MPABKF.pdf</a> <a href="#">Evidenca 8. Plan mesimor dhe syllabuse MPABKF.pdf</a>			
<b>Kriteri 6</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Bazuar në shqyrtimin e DVV, GVJ vëren se lëndët në përmbajtje të kurrikulës së programit të studimit MPABKF në UMSH janë të organizuara sipas kategorive (A-E), në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL." Studenti merr 6 kredite në kategorinë A, pra 10% të krediteve totale të Programit të studimit; 24 kredite (40%) në kategorinë B; 16 kredite (27%) në kategorinë C; 6 kredite (10%) në kategorinë D; dhe 8 kredite (13%) ka detyrimi përmbyllës (E), i cili është ose provim përfundimtar, ose tezë diplome. <a href="#">Evidenca 7. Rregullore e programit MPABKF.pdf</a> <a href="#">Evidenca 8. Plan mesimor dhe syllabuse MPABKF.pdf</a>			
<b>Kriteri 7</b> Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.	GVJ konstaton se praktika profesionale është lëndë e detyrueshme në Planin Mësimor të Programit të Studimit MPABKF në UMSH. Ajo zhvillohet në semestrin e dytë të studimeve përgjatë tre javëve dhe është ekuivalente me 150 orë pune në total që korrespondojnë me 6 kredite ECTS (1 kredit = 25 orë). Zhvillimi i praktikës nga studentët u konfirmua gjatë vizitës në Institucion. Praktika zhvillohej kryesisht pranë vendit të punës së cdo studenti. <a href="#">Evidenca 8. Plan mesimor dhe syllabuse MPABKF.pdf</a> <a href="#">Evidenca 32. Udhezues per praktikat (Bachelor, Master).pdf</a>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## Standardi II.2

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Departamenti i Financë, Bankë, Kontabilitetit është njësia bazë e Fakultetit të Shkencave Ekonomike, si njësi kryesore përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit MPABKF në UMSH. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar verifikohet se Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, është i licensuar me vendim të Këshillit të Ministrave, Nr.177, datë 19.2.2009 dhe i akredituar institucionalisht për herë të

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

15



	<p>parë me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr.124, datë 29.03.2012; Riakredituar me vendim Bordi i Akreditimit Nr. 105, datë 10.11.2017; Riakredituar me vendim Bordi i Akreditimit Nr. 62, datë 18.12.2020.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Ekonomike ofron gjithsej 9 programe studimi (tabela 3 në anekset e RVB): 2 programe studimi në nivelin bachelor, 3 programe studimi në Master i Shkencave, 3 programe studimi në Master Profesional dhe 1 program profesional jo universitar.</p> <p>Programi i studimit MPABKF është hapur më urdhër të MAS nr. 346 më 17/09/2021 dhe i nënshtrohet procesit të akreditimit për herë të parë.</p> <p><a href="#">Evidenca 10. Permbledhese e tabelave per programin MPABKF (1 deri 24).pdf</a></p>																							
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Ekonomike të UMSH si njësi kryesore përgjegjëse për programin e studimit MPABKF ka në përbërjen e tij tre departamente: Departamentin e Ekonomisë, Departamentin e Financë Bankë dhe Kontabilitetit si edhe Departamentin e Informatikës dhe Formimit Shkencor duke plotësuar kështu kriteret e kërkuara sipas kuadrit ligjor në fuqi sipas të cilit një Fakultet organizohet në të paktën tre njësi përbërëse nga të cilat të paktën dy janë departamente.</p> <p><a href="#">Evidenca 10. Permbledhese e tabelave per programin MPABKF (1 deri 24).pdf</a></p>																							
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar (tabela 1 në anekset e RVB), në vitin e fundit akademik 2021-2022, Fakulteti i Shkencave Ekonomike nga 69 staf gjithsej, ka 52 Personel Akademik Efektiv, PAE (pra 75% të stafit total pa stafin ndihmes akademik duke përmbushur kështu kriteret e kërkuara), 17 Personel Akademik me Kontratë, PAK (35% të stafit total pa stafin ndihmes akademik) dhe 0 Personel Ndhmës Akademik, PNA. Në mënyrë të detajuar kemi sa më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="671 1339 1323 1626"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Fakulteti i Shkencave Ekonomike</th> <th colspan="2">2021-2022</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>5</td> <td>5</td> </tr> <tr> <td>Prof.As</td> <td>7</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Dr</td> <td>15</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td>MSc</td> <td>25</td> <td>7</td> </tr> <tr> <td><b>Total</b></td> <td><b>52</b></td> <td><b>17</b></td> </tr> <tr> <td><b>PNA</b></td> <td colspan="2"><b>0</b></td> </tr> </tbody> </table> <p>Bie në sy mungesa e Punonjësve Ndhmës Akademikë (PNA) në nivel njësie kryesore dhe njësie bazë. Të pyetur për këtë gjatë vizitës në Institucion stafi akademik drejtues konfirmoi se PNA janë në nivel të përgjithshëm institucional.</p> <p>Njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit është Departamenti Financë, Bankë, Kontabilitet, informacioni i detajuar për përbërjen akademike të të cilit jepet në tabelën më poshtë:</p>	Fakulteti i Shkencave Ekonomike	2021-2022		PAE	PAK	Prof.Dr	5	5	Prof.As	7	2	Dr	15	3	MSc	25	7	<b>Total</b>	<b>52</b>	<b>17</b>	<b>PNA</b>	<b>0</b>	
Fakulteti i Shkencave Ekonomike	2021-2022																							
	PAE	PAK																						
Prof.Dr	5	5																						
Prof.As	7	2																						
Dr	15	3																						
MSc	25	7																						
<b>Total</b>	<b>52</b>	<b>17</b>																						
<b>PNA</b>	<b>0</b>																							



	Departamenti Financë, Bankë, Kontabilitet	2021-2022	
		PAE	PAK
	Prof.Dr	2	2
	Prof.As	3	1
	Dr	4	1
	MSc	6	1
	<b>Total</b>	<b>15</b>	<b>5</b>
	<b>PNA</b>	<b>0</b>	

Në këtë departament raporti PAE / PAK është 15/5 pra 75/25% duke përmbushur kriteret e nevojshme me ligj. Gjithashtu çfarë bie në sy janë një numër jo i vogël i pedagogëve me tituj dhe grada qoftë ndër PAE apo ndër PAK.

[Evidenca 10. Permbledhese e tabelave per programin MPABKF \(1 deri 24\).pdf](#)

[Evidenca 6. Rregullore e DFBK.pdf](#)

**Kriteri 4.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.

GVJ e ka vërejtur dhe më lart në raport se njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit është Departamenti i Financë, Bankë dhe Kontabilitetit, njëri ndër tre departamentet e Fakultetit të Shkencave Ekonomike pranë UMSH.

GVJ konstaton se ky departament përmbush kërkesat ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të stafit (më specifikisht, ka minimumi 7 pedagogë të brendshëm nga të cilët të paktën 3 janë me tituj/grada).

Përbërja e detajuar sipas titujve dhe gradave në këtë departament është treguar në kriterin 3 më lart. Bazuar në informacionin e marrë pas vizitës në Institucion GVJ evidenton se Departamenti organizohet në grupe mësimore ku grupohen anëtarët e Departamentit që kontribuojnë në lëndët e përafërta, të cilat drejtohen nga përgjegjësit e grup-lëndëve.

[Evidenca 10. Permbledhese e tabelave per programin MPABKF \(1 deri 24\).pdf](#)

[Evidenca 6. Rregullore e DFBK.pdf](#)



**Kriteri 5.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.

Në RVB të përgatitur nga Institucioni, për këtë kriter cilësohet se nuk nevojiten shumë burime personeli ndihmës akademik për praktikat profesionale të këtij programi studimi. Programi i studimit karakterizohet nga praktikë profesionale e detyrueshme prej 3 javësh në semestrin e dytë të studimeve dhe nuk ka praktika klinike apo laboratorike. RVB cilëson se Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Departamenti Financë, Bankë, Kontabilitet kanë personel të mjaftueshëm që angazhohet në ndjekjen e studentëve. Ka PNA në rang universiteti por jo në nivel njësie kryesore dhe as njësie bazë. Detyrat e tyre menaxhohen në nivel institucional.

[Evidenca 10. Permbledhese e tabelave per programin MPABKF \(1 deri 24\).pdf](#)



**Kriteri 6.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo

Si pjesë e DVV, GVJ u njoh edhe me Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Ekonomike në të cilën përmendet roli dhe pozicioni i



<p>program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>koordinatorit të programit të studimit. Në nenin 20, pika 4 të kësaj rregulloreje, si edhe në nenin 7 të rregullores së programit të studimit, përcaktohen detyrat kryesore të koordinatorit i cili luan një rol të rëndësishëm dhe aktiv në planifikimin dhe koordinimin e veprimtarive që garantojnë ecurinë e programit. GVJ u informua gjatë vizitës në institucion se UMSH ka emëruar koordinatorë të programeve master për secilin fakultet. Ata merren me bashkërendimin e detyrave së bashku me përgjegjës të departamentit. Rolet e koordinatorit janë parashikuar në rregulloret përkatëse dhe ata kanë kompetenca të rëndësishme në menaxhimin e detyrave të përditshme të programit të studimit.</p> <p><a href="#">Evidenca 5. Rregullore e FSHE.pdf</a>  <a href="#">Evidenca 7. Rregullore e programit MPABKF.pdf</a></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.</p>	<p>Nga diskutimet e bëra me drejtuesit e njësisë kryesore dhe bazë që ofrojnë programin e studimit MPABKF në UMSH gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstaton se mes koordinatorit të programit të studimit dhe drejtuesit të njësisë bazë përgjegjëse, departamentit të Financë, Bankë, Kontabilitet, ka një bashkëpunim të vazhdueshëm dhe që ndihmon të dyja palët në vendimmarrje të përditshme për një menaxhim efektiv të programit të studimit. Roli dhe detyrimet e koordinatorit përcaktohen në mënyrë të detajuar në rregulloren e njësisë kryesore përgjegjëse për programin e studimit.</p> <p><a href="#">Evidenca 5. Rregullore e FSHE.pdf</a>  <a href="#">Evidenca 7. Rregullore e programit MPABKF.pdf</a></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>
<p><b>Standardi II.3</b>  <b>Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.</b></p>				
<p><b>Kriteret</b></p>		<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>		
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>		<p>GVJ shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar në DVV si edhe informacionet publike të Institucionit në faqen e tij të Internetit (Plani Mësimor i Programit të Studimit, Udhëzime për studentët, etj) dhe konstatoi se në përgjithësi informacionet për elementet e rëndësishme të programit të studimit MPABKF në UMSH disponohen nga Fakulteti (njësia kryesore) dhe Departamenti (njësia bazë) si edhe janë publike dhe të mundshme për t'u aksesuar lirisht.</p> <p><a href="https://www.umsh.edu.al/media/614db597906b9.pdf">https://www.umsh.edu.al/media/614db597906b9.pdf</a>  <a href="https://www.umsh.edu.al/c/216/udhezime">https://www.umsh.edu.al/c/216/udhezime</a></p>		
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>		<p>Bazuar në shqyrtimin e Planit Mësimor të Programit të Studimit MPABKF në UMSH, GVJ konstaton se programi i studimit është i organizuar në module të detyrueshme dhe lëndë me zgjedhje. Programi i studimit përmban praktikë profesionale të detyrueshme</p>		



	<p>sipas kërkesave të ligjit nr. 80/2015 për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.</p> <p><u>Evidenca 8. Plan mesimor dhe syllabuse MPABKF.pdf</u></p>										
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit, GVJ konstaton se organizimi i veprimtarisë mësimore vjetore të Programit të Studimit MPABKF në UMSH shtrihet në një vit akademik me dy semestra që kanë kohëzgjatje normale 15 javë. Programi i plotë shtrihet në dy semestra, në të cilin trajtohen lëndët të cilat janë të vlerësuar me kredite sipas sistemit evropian, ECTS.</p> <p>Programi i studimit ofron në semestrin e parë akademik 4 lëndë me 6 ECTS secila dhe në semestrin e dytë 4 lëndë nga të cilat dy janë lëndë të detyrueshme me nga 6 ECTS secila dhe dy të tjera janë lëndë me zgjedhje me nga 5 ECTS secila. Në semestrin e dytë realizohet edhe praktika profesionale e detyrueshme e cila ka 6 ECTS si edhe diplomimi (ose me provim të përgjithshëm ose me punim diplome) i cili ka 8 ECTS. Gjatë vizitës në Institucion GVJ u bë me dije për një zhvendosje të lëndëve mes semestrave, për të cilën u kërkua dokumentacion shtesë që u vu në dispozicion nga institucioni.</p> <p><u>Evidenca 7. Rregullore e programit MPABKF.pdf</u> <u>Evidenca 8. Plan mesimor dhe syllabuse MPABKF.pdf</u></p>										
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Planit mësimor të programit të studimit MPABKF në UMSH, GVJ konstatoi se ky dokument jep informacion të detajuar në lidhje me ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë auditorit për secilën prej lëndëve.</p> <p>Përsa i përket elementeve të tjera: frekuentimi /ndjekja e programit dhe mënyra e vlerësimit të dijeve, vërejmë se Institucioni i specifikon ato në rregulloren e programit të studimit, si edhe i përforcon në programet lëndore të cdo lënde. Rregullat për nivelin e frekuentimit të mësimit në rastin e programeve të ciklit të dytë specifikohen në rregulloren e programit të studimit (neni 18), pa përcaktuar nivelin sasiar të frekuentimit. Ndërsa në programet lëndore specifikohet masa e frekuentimit në auditor në shkallën 75%.</p> <p>Format e kontrollit të njohurive janë të shtrira në mënyrë të vazhduar gjatë gjithë vitit dhe në mënyrë të përmbledhur janë paraqitur në tabelat në anekset e RVB:</p> <table border="0"> <tr> <td>• Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive</td> <td>10%</td> </tr> <tr> <td>• Detyra kursi</td> <td>20%</td> </tr> <tr> <td>• Testimet gjatë vitit</td> <td>30 %</td> </tr> <tr> <td>• Provimi përfundimtar</td> <td>40 %</td> </tr> <tr> <td>• <b>Totali</b></td> <td><b>100%</b></td> </tr> </table> <p><u>Evidenca 7. Rregullore e programit MPABKF.pdf</u> <u>Evidenca 8. Plan mesimor dhe syllabuse MPABKF.pdf</u></p>	• Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive	10%	• Detyra kursi	20%	• Testimet gjatë vitit	30 %	• Provimi përfundimtar	40 %	• <b>Totali</b>	<b>100%</b>
• Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive	10%										
• Detyra kursi	20%										
• Testimet gjatë vitit	30 %										
• Provimi përfundimtar	40 %										
• <b>Totali</b>	<b>100%</b>										



<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>GVJ pasi shqyrtoi Rregulloren e programit të studimit MPABKF në UMSH, kreu III, konstatoi se ky dokument përmban detajet e nevojshme mbi kushtet, kriteret dhe procedurat që duhet të ndiqen për t'u pranuar në programin e studimit. Kjo rregullore përcakton edhe procedurat dhe kriteret për transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve.</p> <p>MPABKF mund të ndiqet nga studentë që kanë së paku nivelin Bachelor dhe 180 ECTS dhe studentë, pa kriterin e plotësimeve të krediteve (kreu iii, neni 12, pika 2 e rregullores së programit të studimit), që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve pranë UMSH apo në universitete të tjera në përputhje me kriterin e njehsimit të diplomave. Në këtë program pranohen edhe studentë nga fusha apo profile të ngjashme studimi me kushtin e plotësimit të krediteve dhe me kalimin e procedurës së ekuivalentimit të diplomës. <i>GVJ konstatoi që studentë të programit të studimit kishte edhe me profil jo ekonomik dhe përfshirja e tyre në program ishte bërë pa iu nënshtruar një testimi apo marrjes së detyrueshme të kurseve paraprake formuese.</i> GVJ konstaton megjithatë që këta student, në të shumtën e rasteve kanë një profil punësimi që përputhet me profilin e programit të studimit.</p> <p>Transferimet e studentëve rregullohen edhe me një udhëzues të vecantë ku jepen më shumë detaje për mënyrën e transferimit të studimeve dhe kriteret që duhet të plotësohen nga studentët për t'u pranuar kërkesa për transferim. Aktualisht programi i studimit nuk ka pasur transferime, por vetëm një c' regjistrim për arsye personale.</p> <p><a href="#">Evidenca 7. Rregullore e programit MPABKF.pdf</a>  <a href="#">Evidenca 17. Udhëzuesi i Transferimeve.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Për të analizuar këtë kriter, GVJ ka shqyrtuar programet lëndore përkatëse të programit të studimit MPABKF në UMSH të cilat janë pjesë e DVV. Referuar këtyre të dhënave GVJ konstaton se syllabusi i cdo lënde përmban informacionet e nevojshme të detajuara, në lidhje me praktikat në auditor, seminarat (nëse ka) dhe orë laboratorit (nëse ka) në përputhje kjo me VKM nr.41 si edhe mënyrën e vlerësimit që ndiqet në cdo lëndë.</p> <p>Nota përfundimtare është rezultante e këtyre elementëve të vlerësimit: provimet e ndërmjetme dhe finale + detyra kursi/projekte individuale + aktivizimi në seminare.</p> <p><a href="#">Evidenca 8. Plan mesimor dhe syllabuse MPABKF.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Referuar RVB, syllabuset paraqiten nga titullarët e lëndëve me të paktën titullin "Doktor i Shkencave" dhe analiza e cilësisë së tyre është përgjegjësi e njësisë bazë, në këtë rast e Departamentit Financë, Bankë, Kontabilitet. Të pyetur gjatë vizitës në Institucion anëtarë të stafit u shprehën për procedurën që ndjekin për përmirësimin e programeve lëndore. Procedura parashikon që në fillim të vitit akademi të kërkohen ndryshime apo përditësime të syllabuseve brenda nivelit të lejuar prej 20%. Tre ndryshimet</p>





	<p>kryesore që nxiten nga drejtuesit janë: (1) eliminimi i mbivendosjeve; (2) rishikimi dhe përditësimi i literaturës duke përfshirë tekste akademike të përdorura në botë; (3) lidhja e lëndëve dhe e disiplinave me njëra tjetrën. Propozimet bëhen në fillim të vitit akademik, në mbledhje departamenti, i bëhet e ditur përgjegjësit të departamentit dhe diskutohet në mbledhje. Nëse kërkesa për ndryshim është deri në 20% ajo miratohet nga përgjegjësi i departamentit</p> <p>Në anekset e RVB (tabela 11) nuk vërehen ndryshime nga Plani Mësimor i Licensuar. Megjithatë, gjatë vizitës në Institucion, GVJ u vu në dijeni për një zhvendosje të një prej lëndëve me zgjedhje nga një semestër në tjetrin. Për këtë procedurë GVJ kërkoi dorëzimin si evidencë të vendimit të njësisë kryesore dhe baze, dokumentacion që u vendos në dispozicion nga Institucioni.</p> <p><u>Evidenca 10. Permbledhese e tabelave per programin MPABKF (1 deri 24).pdf</u>  <u>Evidenca 7. Rregullore e programit MPABKF.pdf</u>  <u>12. Vendim departamenti per zhvendosjen e lendeve me zgjedhje.pdf</u></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi II.4</b>	
<b>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Ligji nr. 80/2015 për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, neni 75, pika 6 përcakton se programet profesionale organizohen me 60 ose 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është një vit ose dy vite akademike. GVJ konstaton se ngarkesa e programit të studimit në MPABKF në UMSH është me 60 kredite dhe kohëzgjatje normale është një vit akademik duke e përmbushur këtë kriter. <u>Evidenca 7. Rregullore e programit MPABKF.pdf</u> <u>Evidenca 8. Plan mesimor dhe syllabuse MPABKF.pdf</u>
<b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve.	Nga shqyrtimi i Rregullores së programit të studimit MPABKF dhe përmbajtjes së Planit Mësimor nga GVJ u konstatua se programi i studimit parashikon lëndë të ndryshme të formimit të nevojshëm profesional dhe njohuri në disiplina të lidhura me financën, kontabilitetin dhe auditimin. Përmbajtja e përgjithshme e moduleve dhe transmetimi i njohurive sikurse gjykohet nga GVJ duket se lehtësojnë formimin teorik dhe praktik të studentëve në funksion të punësimit të tyre.



	<p><a href="#">Evidenca 7. Rregullore e programit MPABKF.pdf</a>  <a href="#">Evidenca 8. Plan mesimor dhe syllabuse MPABKF.pdf</a></p>												
<p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimi profesional.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Planit mësimor të programit të studimit që është pjesë e DVV, GVJ konstaton se shpërndarja e ngarkesës mësimore në dy semestrat sipas lëndëve dhe moduleve është përgjithësisht e mirë menduar dhe mundëson kryesisht arritjen e objektivave formuese të programit dhe rezultatet e pritshme të të nxënit. (Objektivat formuese të këtij programi studimi specifik dhe rezultatet e pritshme të të nxënit dhe aftësimi profesional gjenden në rregulloren e programit të studimit dhe përforcohen në programet e vecanta lëndore).</p> <p><a href="#">Evidenca 7. Rregullore e programit MPABKF.pdf</a>  <a href="#">Evidenca 8. Plan mesimor dhe syllabuse MPABKF.pdf</a></p>												
<p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teoripraktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>GVJ pasi shqyrtoi tabelat në anekset e RVB si edhe programet lëndore të lëndëve të ofruara në programin e studimit MPABKF në UMSH, konfirmon se këto lëndë ofrojnë nivel përgjithësisht të kënaqshëm në përputhje me profilin dhe fushën e programit. Emërtimi i tyre paraqet ngjashmëri me programe ndërkombëtare të kësaj disipline, sipas njohjes që anëtarët e GVJ kanë me programe studimi ndërkombëtare në fushën e auditimit të brendshëm dhe kontrollit financiar.</p> <p>Studentët shprehen në përgjithësi të kënaqur me lëndët e ofruara nga programi dhe u shprehën se ato plotësojnë nevojat për informacion të programit dhe se ata ndjehen të kompletuar në njohuritë që marrin.</p> <p><i>Megjithëkëtë, në gjykimin e GVJ dhe në njohurinë e tyre, ata sugjerojnë shtimin e disa temave dhe kapitujve specifikë për auditimin e sistemeve të informacionit në ndonjë prej lëndëve ekzistuese të programit. Kjo do forconte dhe thellonte njohuritë që studentët marrin në këtë program.</i></p> <p><a href="#">Evidenca 8. Plan mesimor dhe syllabuse MPABKF.pdf</a>  <a href="#">Evidenca 10. Permbledhese e tabelave per programin MPABKF (1 deri 24).pdf</a></p>												
<p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Përsa i përket strukturës së programit, në tabelën 13 në anekset e RVB gjendet informacion në lidhje me ngarkesën totale të programit të studimit MPABKF në UMSH. Nga kjo tabelë shohim elementet e mëposhtme të ngarkesës totale:</p> <table style="margin-left: 40px;"> <tr> <td>• Leksione</td> <td>240 orë</td> </tr> <tr> <td>• Seminare</td> <td>210 orë</td> </tr> <tr> <td>• Ushtrime / Laboratore</td> <td>0 orë</td> </tr> <tr> <td>• Praktikë profesionale</td> <td>75 orë</td> </tr> <tr> <td>• Diploma/ Provim Formimi</td> <td>15 orë</td> </tr> <tr> <td><b>Totali</b></td> <td><b>540 orë</b></td> </tr> </table> <p>Raporti <b>Teori</b> (leksione) / <b>Praktikë</b> (sem+usht+proj+prakt.prof) rezulton 240 orë teori / 300 orë praktikë ose afërsisht <b>44% / 56%</b>.</p> <p><a href="#">Evidenca 10. Permbledhese e tabelave per programin MPABKF (1 deri 24).pdf</a></p>	• Leksione	240 orë	• Seminare	210 orë	• Ushtrime / Laboratore	0 orë	• Praktikë profesionale	75 orë	• Diploma/ Provim Formimi	15 orë	<b>Totali</b>	<b>540 orë</b>
• Leksione	240 orë												
• Seminare	210 orë												
• Ushtrime / Laboratore	0 orë												
• Praktikë profesionale	75 orë												
• Diploma/ Provim Formimi	15 orë												
<b>Totali</b>	<b>540 orë</b>												
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p><i>Nga shqyrtimi i bërë për syllabuset, GVJ konstaton që ky kriter përmbushet kryesisht, me disa përjashtime si psh tekste të viteve 2012, 2015 apo edhe të vitit 2009 (dhe në lëndë të rëndësishme për programin si Analiza dhe Organizimi i Kontrollit të Brendshëm Financiar). GVJ rekomandon përditësimin e këtyre teksteve. GVJ sugjeron përditësimin</i></p>												



	e literaturës cka do të evitonte edhe përdorimin e terminologjisë disi të vjetëruar që u vërejt në disa prej syllabuseve. <u>Evidenca 8. Plan mesimor dhe syllabuse MPABKF.pdf</u>								
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë.	Bazuar në analizën që GVJ i bëri programeve lëndore të programit MPABKF në UMSH, përmbajtja e tyre në përgjithësi mundëson kryesisht përfitim të dijeve dhe aftësive nga ana e studentëve të kompetencave teknike të synuara për një program të masterit profesional.								
<b>Kriteri 8.</b> Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Në dijeni dhe në përputhje me njohjen e GVJ, në vija të përgjithshme organizimi i programit të studimit siguron kompetenca dhe formim të thelluar profesional. Në kriteret 4 dhe 6 më lart GVJ shpreh gjykimin e saj profesional për pasurimin dhe rritjen e cilësisë së përmbajtjes së programit të studimit. <u>Evidenca 7. Rregullore e programit MPABKF.pdf</u> <u>Evidenca 8. Plan mesimor dhe syllabuse MPABKF.pdf</u>								
<b>Kriteri 9.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimitin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës.	Nga analiza e përmbajtjes së programit të studimit MPABKF në UMSH konstatojmë se ky program mundëson kryesisht punësimitin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës por pa u hequr të drejtën që u jep ligji. Duhet të shihen kriteret 4 dhe 6 më lart ku GVJ shpreh gjykimin e saj për pasurimin dhe rritjen e cilësisë së përmbajtjes së programit të studimit. <u>Evidenca 7. Rregullore e programit MPABKF.pdf</u> <u>Evidenca 8. Plan mesimor dhe syllabuse MPABKF.pdf</u>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

### Standardi II.5

**Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Nga shqyrtimi i tabelave me të dhëna, (dhe konkretisht tabela 4 në anekset e RVB), konstatohet se Institucioni përmbush kërkesat ligjore në fuqi dhe më konkretisht, kërkesat e VKM Nr. 418, viti 2017, pasi Personeli Akademik Efektiv përballon më shumë se 70% të orëve mësimore të këtij programi studimi, ndërsa Personeli akademik me kontratë angazhohet në më pak se 30 % të orëve mësimore të programit të studimit Për vitin akademik 2021 – 2022 kanë dhënë mesim 6 pedagogë nga të cilët të gjithë janë PAE pra realizojnë 100% të orëve mësimore të programit të studimit. Në personelin akademik efektiv të angazhuar në këtë program studimi (tabela 4 në shtojcat e RVB) vihet re se 33% e tyre kanë titullin akademik Profesor i Asociuar (2 nga 6 staf gjithsej), kurse 67% kanë gradën shkencore Doktor (4 nga 6 staf gjithsej).



	<p><a href="#">Evidenca 10. Permbledhese e tabelave per programin MPABKF (1 deri 24).pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>GVJ vuri re se të gjithë pjesëtarët e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit MPABKF në UMSH, kishin grada e tituj.</p> <p>Nga shqyrtimi i CV të tyre, sfondi i formimit akademik, por jo vetëm (edhe ai praktik dhe kërkimor) i personelit shfaqet në përgjithësi, në përputhje me angazhimin e tyre në programin e studimit.</p> <p><a href="#">Evidenca 10. Permbledhese e tabelave per programin MPABKF (1 deri 24).pdf</a></p> <p><a href="#">Evidenca 12. CV e stafit akademik te programit te studimit MPABKF.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Nga shqyrtimi i të dhënave të personelit akademik efektiv të angazhuar në realizimin e programit të studimit, GVJ mund të shprehet se fokusi profesional dhe formimi dhe niveli akademik dhe kërkimor i tyre është i kënaqshëm dhe i mjaftueshëm për të garantuar mbulimin e programeve dhe moduleve mësimore të programit të studimit.</p> <p>Nga shqyrtimi i CV të personelit u konstatua se ata i kanë fituar gradat shkencore dhe / ose titujt në disiplina që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me lëndët që ata mbulojnë në programin e studimit duke garantuar përmbushjen e këtij kriteri.</p> <p><a href="#">Evidenca 12. CV e stafit akademik te programit te studimit MPABKF.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Dokumentacioni i dorëzuar nga Institucioni, si edhe të dhënat në DVV dëshmojnë shumë marrëveshje të nënshkruara me biznese dhe institucione të ndryshme me qëllim kryerjen e praktikave mësimore dhe profesionale por jo vetëm. Në tabelën 5 në anekset e RVB, listohen 25 institucionet me të cilat UMSH ka marrëveshje bashkëpunimi për praktikat profesionale për këtë program studimi.</p> <p>GVJ, gjatë takimit me studentët, u informua megjithatë se praktika po kryhej pranë vendeve përkatëse të punësimiti të studentëve, por e orientuar dhe e kontrolluar nga Institucioni.</p> <p><a href="#">Evidenca 11. Marreveshjet e bashkepunimit midis UMSH dhe Institucioneve te tjera.pdf</a></p> <p><a href="#">Evidenca 15. Memo mbi bashkepunimin me bizneset.pdf</a></p> <p><a href="#">Evidenca 14. Formularet e praktikës.pdf</a></p> <p><a href="#">Evidenca 32. Udhezues per praktikat (Bachelor, Master).pdf</a></p> <p><a href="#">Evidenca 33. Udhezues per provimin e formimit.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Sipas Planit Mësimor dhe programeve lëndore, programi i studimit MPABKF në UMSH nuk ka orë laboratorike e megjithatë në RVB për këtë kriter, Institucioni shprehet se kanë burime njerëzore dhe financiare për të garantuar mirëmbajtjen e laboratorëve dhe ambienteve të tjera në funksion të objektivave të përgjithshme të institucionit.</p> <p><a href="#">Evidenca 8. Plan mesimor dhe syllabuse MPABKF.pdf</a></p>





Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht

### Standardi II.6

**Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.**



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Sipas RVB të përgatitur nga Institucioni për këtë kriter, UMSH shfrytëzon marrëveshjet e bashkëpunimit për të mbajtur kontakte me tregun e punës dhe për të reflektuar nevojat e tyre me njohuri dhe kompetenca që duhen përcuar tek studentët e programeve që UMSH ofron. GVJ konstaton që Institucioni ka kryer analizë të përgjithshme të tregut të punës për të gjitha programet e studimit të ofruara nga Fakulteti i Shkencave Ekonomike. Në DVV gjendet edhe një memo shpjeguese për cilësinë e bashkëpunimit me bizneset dhe synimet dhe pritshmëritë nga këto bashkëpunime.</p> <p><a href="#">Evidenca 9. Analiza e tregut te punes FSHE.pdf</a></p> <p><a href="#">Evidenca 15. Memo mbi bashkepunimin me bizneset.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Sipas RVB të përgatitur nga Institucioni për këtë kriter, UMSH i konsideron studentët, gjykimin dhe vlerësimin e tyre si një burim të rëndësishëm informacioni për përmirësim. Opinioni i studentëve merret nëpërmjet strukturave si Njësia e sigurimit të cilësisë apo Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës të cilat ishin përgjegjëse për organizimin e procesit të vlerësimit të programit nëpërmjet formularëve me studentët dhe procedurës së punës me fokus grupet. GVJ kërkoi evidencë shtesë në lidhje me analizat e bëra mbi informacionin e siguruar nëpërmjet këtyre dy instrumentave, evidenca që u vunë në dispozicion nga Institucioni.</p> <p><a href="#">Evidenca 25. Procedura e punes me fokus grupet.pdf</a></p> <p><a href="#">5. Përpunimi i pyetesoreve te studenteve.pdf</a></p> <p><a href="#">6. Praktike e fokus grupeve.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit.</p>	<p>Ky kriter nuk aplikohet ende për programin e studimit MPABKF në UMSH pasi ende nuk ka studentë të diplomuar. Megjithatë në RVB institucioni shprehet që në përgjithësi synon të mbajë kontakte të vazhdueshme dhe konstruktive me studentët alumni. GVJ hasi evidencë në DVV për formularët që Institucioni ka hartuar për mbledhjen e të dhënave nga studentët e diplomuar në programe të tjera studimi. Këta formularë do të përdoren më vonë edhe për këtë program studimi.</p> <p><a href="#">Evidenca 19. Formular Alumni.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me</p>	<p>Sipas RVB të përgatitur nga Institucioni për këtë kriter, UMSH ka kapacitete didaktike, menaxheriale dhe infrastrukturore që t'i përgjigjet kërkesave dhe nevojave për programe specifike që mund të vijnë nga institucione publike e private sipas fushave të ekspertizës që ka. GVJ gjithashtu, mbështetur në tërësinë e faktorëve që ka analizuar</p>



kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi.	<p>gjatë shqyrtimit të DVV për programin e studimit MPABKF, si edhe në informacionin mbi zhvillimet e fundit në vend (rifreskimi dhe përditësimi i legjislacionit shqiptar në lidhje me menaxhimin dhe kontrollin financiar në kuadër të Integritimit në BE), gjykon se ofrimi i këtij program studimi në këtë periudhë është në përputhje me kërkesat dhe nevojat e zhvillimit aktual të vendit tonë.</p> <p><u>Mendimi i Dekanit - Programi i Studimit MPABKF.pdf</u>  <u>Evidenca 2. Plani strategjik i zhvillimit UMSH.pdf</u></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>



<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>



### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV, dhe nga raportimet në RVB, GVJ konstaton se Institucioni është i angazhuar në ofrimin e trajnimeve me fokus mësimdhënien për stafin akademik. Institucioni ka hartuar udhëzues mbi përdorimin e platformave të mësimin online. Por GVJ konstatoi se programi i trajnimeve lidhej me vitin akademik 2020 – 2021 dhe jo me vitin e fundit akademik. Të pyetur gjatë vizitës në Institucion kjo u shpjegua me faktin se në vitin e fundit akademik nuk ka pasur prurje të reja të stafit dhe trajnimet nuk kanë qenë të nevojshme. GVJ pajtohet me këtë gjykim, dhe me faktin që nuk ka patur zhvillime të reja në teknologjitë e mësimdhënies që të kenë bërë të nevojshme ofrimin e trajnimeve për stafin ekzistues.</p> <p><u>Evidenca 21. Udhëzues mbi përdorimin e platformave të mesimit online.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 24. Programi i trajnimeve 2020-2021.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Nga shqyrtimi nga ana e GVJ i dokumenteve në DVV, u konstatua se UMSH ka implementuar nëpërmjet NJSBC disa mekanizma monitorimi dhe vlerësimi të aftësive mësimdhënëse të personelit akademik. (1) Vlerësimi i mësimdhënies në auditor, kryesisht për anëtarët e personelit akademik të punësuar rishtas, por jo vetëm; (2) Vlerësimi i pedagogut dhe i lëndës nga studentët I cili kryhet në fund të çdo semestri, duke ruajtur anonimatën e tyre, nëpërmjet formularëve të vlerësimit të pedagogut dhe të lëndës të cilët fokusohen në vlerësim të përmbajtjes së lëndës si edhe të aftësive pedagogjike e didaktike të personelit akademik të angazhuar me programin. Strukturë përgjegjëse për vlerësimin e aftësive mësimdhënëse dhe cilësisë didaktike ishte NJSBC.</p> <p><u>Evidenca 22. Plan kontrolli DFBK.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 23. Formulari i Vlerësimit të Pedagogut dhe Lëndës nga Studenti.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Përfshirja e studentëve në procesin e vlerësimit të metodave të mësimdhënies është e garantuar sipas rregullores së organizimit të UMSH, neni 55, pika 1.d.</p> <p>Gjatë vizitës në Institucion, GVJ pyeti studentët e programit të studimit MPABKF në UMSH për t'u informuar në lidhje me mënyrën dhe shkallën e përfshirjes së tyre në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve duke pasur konfirmim që Institucioni i përfshin studentët në këtë proces.</p> <p><u>Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH.pdf</u></p>



	<u>Evidenca 23. Formulari i Vleresimit te Pedagogut dhe Lendes nga Studenti.pdf</u>			
<b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Sipas RVB të përgatitur nga Institucioni për këtë kriter, UMSH pas përpunimit të informacionit të grumbulluar nga instrumentet e kontrollit, ua përcjell këtë informacion njësive përgjegjëse në mbështetje të procesit të vlerësimit të performancës akademike të secilit pedagog në përfundim të vitit akademik. Gjetjet i përcillen rektoratit dhe drejtuesve të njësive kryesore si edhe vetë personelit akademik me qëllim marrjen e masave në funksion të rritjes së cilësisë së punës në institucion. Rezultatet e vlerësimit bëhen publike në formë anonime. Këto praktika u konfirmuan edhe gjatë intervistave me stafin në vizitën në Institucion.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Nga RVB për këtë kriter duket se Institucioni i përdor të dhënat nga analiza e vlerësimeve për t'i bërë objekt diskutimi në mbledhje departamenti për të promovuar shembujt më të mirë. Bazat që garantojnë nxitjen e personelit akademik në përmirësimin e aftësive të tyre didaktike dhe mësimdhënëse janë parashtruar në dy dokumenta: Plani Strategjik i Zhvillimit të Institucionit si edhe Plani strategjik i zhvillimit të programit të studimit MPABKF në UMSH. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ u informua nga zyra e burimeve njerëzore se Institucioni aplikon prej të paktën pesë viteve sistemin e incentivimit të bazuar në vlerësimin e performancës. <u>Evidenca 2. Plani strategjik i zhvillimit UMSH.pdf</u> <u>Evidenca 3. Strategjia e zhvillimit te programit MPABKF.pdf</u>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi III.2

**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Nga shqyrtimi i Planit Mësimor të Programit të Studimit MPABKF në UMSH, edhe e dosjes së programeve lëndore, por edhe nga konfirmimet gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstaton se format e mësimdhënies për këtë program specifik janë leksionet, seminarët, detyrat e kursit/ esetë dhe praktikat profesionale.  Në RVB të paraqitur nga Institucioni referohen edhe leksione të hapura me të ftuar nga bota e biznesit si një mundësi që studentët të ballafaqohen me kërkesat praktike të tyre. Megjithatë si evidencë në DVV paraqitet një material vetëm me foto nga eventet nga të cilat nuk kuptohet qartë as koha dhe as përmbajtja e leksioneve të hapura. GVJ kërkoi evidencë shtesë në lidhje me leksionet e hapura, evidencë që u siguroa nga institucioni.  <u>Evidenca 8. Plan mesimor dhe syllabuse MPABKF.pdf</u> <u>Evidenca 31. Leksione te hapura ne programin MPABKF.pdf</u>
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies	Gjatë vizitës së GVJ në Institucion, personeli akademik pranon se angazhohet në krijimin e një mjedisi që ofron mundësi të barabarta, pa diskriminim, për gjithë studentët në arritjen e qëllimeve të tyre akademike. Në bazë të fushës dhe natyrës së programit të studimit si



<p>mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>dhe feedback-ut të marrë nga studentët, personeli akademik përdor forma të ndryshme të mësimdhënies, përveç atyre klasike si prezantimet e studentëve, detyra të shkurtra me shkrim (ese), projekte studimi në grup për të nxitur bashkëpunimin mes palëve në kushte simuluese të punës etj. Në RVB për këtë kriter, Institucioni garanton qasje inkurajuese ndaj studentëve me aftësi ndryshe si edhe ofrimin e konsultimeve shtesë për studentët që shprehin një nevojë të tillë (neni 13, dhe neni 25, pika b, Rregullorja e programit të Studimit). <a href="#">Evidenca 7. Rregullore e programit MPABKF.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Në RVB përmendet Plani Strategjik i Zhvillimit të Institucionit si edhe Plani strategjik i zhvillimit të programit të studimit MPABKF në UMSH si dy shtyllat që garantojnë nxitjen e personelit akademik në përmirësimin e aftësive të tyre didaktike dhe mësimdhënësve. Gjatë shqyrtimit të DVV, GVJ hasi evidencë të përpjekjeve institucionale në drejtim të trajnimit të stafit pavarësisht se këto trajnime lidheshin me një vit akademik më të hershëm. GVJ gjithashtu konfirmoi në ambientet e institucionit ekzistencën e kushteve të mira të mësimdhënies që garantojnë një proces të mirë didaktik për të dyja palët në auditor. <a href="#">Evidenca 2. Plani strategjik i zhvillimit UMSH.pdf</a> <a href="#">Evidenca 3. Strategjia e zhvillimit te programit MPABKF.pdf</a> <a href="#">Evidenca 30. Udhezues per studentet 2020-2021.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i CV të stafit akademik si edhe nga diskutimet me përfaqësues të stafit akademik të Institucionit gjatë vizitës, GVJ formoi bindjen se UMSH ka punësuar staf të përgatitur të cilët janë kompetentë në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve të rëndësishme për këtë program studimi. Ata gjithashtu përdorin metoda të larmishme në mësimdhënie për të nxitur pjesëmarrjen e studentëve në procesin mësimor. <a href="#">Evidenca 12. CV e stafit akademik te programit te studimit MPABKF.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Sipas RVB për këtë kriter, procesi i vlerësimit të pedagogëve përfshin edhe studentët nëpërmjet dy instrumentave: (1) pyetësorëve të cilët ata i plotësojnë në mënyrë elektronike dhe anonime në fund të çdo semestri, dhe (2) punës me fokus grupet e studentëve ku diskutohen hapur problematikat e lidhura me procesin mësimor. GVJ konfirmoi se pyetësorët e studentëve përmbajnë pyetje që lidhen me vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies nga pedagogët. Gjithashtu, RVB deklaroi se analiza e pyetësorëve i përcillet strukturave drejtuese në mënyrë që këto të fundit të marrin masat e nevojshme për të reflektuar mendimet dhe sugjerimet e studentëve. <a href="#">Evidenca 23. Formulari i Vleresimit te Pedagogut dhe Lendes nga Studenti.pdf</a> <a href="#">Evidenca 25. Procedura e punes me fokus grupet.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimin.</p>	<p>Nga diskutimet me përfaqësues të Institucionit gjatë vizitës, GVJ formoi bindjen se personeli akademik përdor realisht metoda të ndryshme për të garantuar angazhimin e studentëve në procesin mësimor. Personeli u shprehën të motivuar nga shkalla e përkushtimit të studentëve cka tregon se orët e mësimin janë tërheqëse për ta. Po kështu, kjo konfirmohet edhe nga studentët e programit të studimit të cilët u treguan vazhdimisht konfidencë në pohimet e tyre për perceptimin pozitiv që kishin për cilësinë e mësimin.</p>



<p><b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Bazuar në pyetjet drejtuar studentëve të programit të studimit GVJ konstaton se një ndër format e mësimdhënies të zbatuara nga pedagogët e UMSH për programin MPABKF ishte nxitja e vazhdueshme e studentëve që të ishin pjesë aktive gjatë procesit mësimor. Personeli akademik dukej se i nxiste studentët që nëpërmjet pyetjeve të reflektonin gjatë mësimin, duke i caktuar secilit përgjegjësi të qarta për detyra specifike. Kështu studentët promovohen që të fitojnë aftësi shprehëse dhe argumentuese dhe jo thjesht përgjigje të paargumentuara.</p> <p>Në përgjithësi GVJ formoi opinionin se kjo metodë mësimdhënie, inkurajon të menduarin e pavarur dhe kritik nga ana e studentëve si edhe i bën ata më të hapur dhe të aftë të artikulojë lirisht opinionet e tyre.</p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi III.3</b>  <b>Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Bazuar në dokumentat e dorëzuara si pjesë e DVV si edhe në konstatime gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstaton se UMSH garanton hapësira dhe infrastrukturë të mjaftueshme dhe të mirëmbajtur që mundësojnë kryerjen në mënyrë komode të procesit mësimor. Ambientet mësimore dhe ato rekreative ishin të pajisura me sistem ngrohje e ftohje, me ashensor dhe mundësi lëvizje edhe për studentët me aftësi ndryshe.</p> <p><a href="#">Evidenca 26. Relacion i Verifikimit te Godines.pdf</a>  <a href="#">Evidenca 38. Informacion mbi Infrastrukturen e UMSH.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave.</p>	<p>Sic u konstatua gjatë vizitës në UMSH klasat janë të pajisura me mjetet e nevojshme për të bërë funksional në tërësi procesin mësimor, si kompjutera, projektorë, etj. Layout i përdorur në salla krijon komoditet për të përshtatur mësimdhënien edhe si grup por edhe në formën e grupeve të vogla studimore për diskutime.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>Nga vizita në Institucion dhe diskutimet me personelin akademik dhe me studentët u konstatua përdorimi i rrjetit ëireless me akses të lirshëm brenda ambienteve të UMSH. Programi i studimit MPABKF në UMSH, për shkak të përmbajtjes së tij duket se nuk e ka të nevojshme përdorimin e softuerëve secifikë përtej programeve standard të paketës Microsoft Office. Si sistem për menaxhimin e procesit mësimor, u konfirmua që përdoren sistemi SMS – Student Management System dhe modulet e hapura LMS si Google Classroom.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive</p>	<p>Nga shqyrtimi i programeve lëndore, GVJ konstatoi se në pothuajse të gjitha lëndët ofrohen tituj të larmishëm në literaturë (të detyrueshëm dhe të sugjeruar) në dispozicion të studentëve. Tekstet janë në përgjithësi prestigjioze dhe tituj të respektuar në fushat përkatëse. Gjatë vëzhgimit të literatures së programeve lëndore GVJ konstatoi mangësi të vogla si: përdorimin e të njëjtit tekst (Auditimi)</p>





<p>të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>për disa tema në dy lëndë të ndryshme apo në një lëndë tjetër (Kontabiliteti i Sigurimeve dhe i Bankave) teksti i cituar në literaturën ndihmëse nuk ka lidhje me temat përkatëse. <i>Sugjerimi i GVJ, sic edhe jemi shprehur më herët në këtë raport, është përditësimi i literaturës me botime të viteve më të fundit aty ku kjo është e mundur.</i></p> <p>Të pyetur gjatë vizitës në Institucion, studentët u shprehën se atyre u vendosen në dispozicion përmbledhje me slide apo ushtrime dhe raste studimore për cdo lëndë. Tekstet e plota mësimore gjendeshin në bibliotekë dhe mund të aksesoheshin lirisht nga studentët e interesuar.</p> <p><u>Evidenca 10. Permbledhese e tabelave per programin MPABKF (1 deri 24).pdf</u>  <u>Evidenca 27. Kerkese per libra DFBK.pdf</u>  <u>Evidenca 35. Manual mbi perdorimin nderfaqjes Biblioteka Online UMSH.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Në RVB të përgatitur nga Institucioni gjendet informacioni se Biblioteka e UMSH ka 4 ambiente dhe sipërfaqe 157 metra katrorë në përdorim. Numri i titujve është 4240 tituj gjithsej. Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se vetëm një ambient plotësonte standardin e një biblioteke të mirëfilltë.</p> <p>Hapësirat në bibliotekë gjykohen nga ana e GVJ si të mjaftueshme për të plotësuar nevojat e studentëve të programit të studimit MPABKF në UMSH.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Në RVB të Institucionit për këtë kriter (tabela 16 në anekset e RVB) përmendet përdorimi i bibliotekës online Edward Elgar Publishing me licencë 1 vjecare dhe me të drejtë rinovimi. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ u informua edhe për aksesin në bibliotekën COBIS.</p> <p>Të pyetur për shkallën e shfrytëzimit të burimeve online pedagogët u shprehën se i përdorin burimet nga bibliotekat elektronike kryesisht për të përgatitur materiale shpesh dhe detyra kursi për studentët, megjithatë duke theksuar që në lidhje me këtë program studimi, fokusi i tyre kishte qenë vazhdimisht praktika më shumë sesa teoria.</p> <p><u>Evidenca 10. Permbledhese e tabelave per programin MPABKF (1 deri 24).pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Nga vizita në Institucion, GVJ konfirmoi se sallat e UMSH janë të pajisura me PC dhe projektorë të cilat mund të shfrytëzohen nga studentët për realizimin e punësve dhe detyrave të kursit sipas nevojave të tyre. Përfaqësues të Institucionit u shprehën se studentët mund të punojnë lirisht edhe në Bibliotekë për detyrat e kursit. Orët laboratorike nuk parashikohen specifikisht në këtë program studimi.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>GVJ konstaton se për këtë kriter RVB jep informacion të përgjithshëm, jo specifik dhe mungojnë referencat. Për shkak edhe se në DVV nuk u ndeshën evidenca të mjaftueshme, GVJ u interesua gjatë vizitës në Institucion në lidhje me platformat e-learning të shfrytëzuara nga UMSH duke u informuar se Institucioni përdor kryesisht Google Classroom (në rolin e Learning Management System) dhe SMS, Student Management System. Të dyja këto platforma u konfirmuan si nga stafi akademik ashtu edhe nga studentët e programit të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Në RVB për këtë kriter gjejmë se UMSH përdor sistemin e informacionit SMS (Sistemi i Menaxhimit të Studentit) i cili është një sistem interaktiv ku të gjithë përdoruesit (staf, studentë, personel akademik) mund të regjistrohen duke përdorur llogarinë e personale</p>



	<p>të emailit. Ky sistem sigurisht përdoret edhe për studentët e programit të studimit MPBAKF në UMSH.</p> <p>SMS është një sistem modular i organizuar nga role dhe njësi përkatëse në universitet që ofron funksionalitet edhe për personelin akademik edhe për studentët (por edhe për stafin ndihmës akademik dhe atë administrative sipas roleve të tyre). Personeli akademik ka akses në informacione rreth lëndëve aktuale dhe atyre të caktuara më parë. Ata mund të përditësojnë programin lëndor, të shohin pjesëmarrjen e studentëve në mësim, të vendosin dhe të finalizojnë vlerësimin e detajuar vjetor, nota, etj. Kurse studentët, mund të përdorin të dhënat e tyre personale dhe informacionin që lidhen me programin e tyre të studimit, mund të regjistrohen në lëndë, mund të shikojnë veprimtarinë akademike të vazhdueshme të lëndëve të regjistruara gjatë semestrit, të kontrollojnë pjesëmarrjen, datat e provimit, notat e përkohshme dhe notat përfundimtare. Gjithashtu, në sistem, ata mund të aksesojnë kurrikulën e programit, listën e notave, llogaritjen e notave, programin javor, kërkesat dhe njoftimet, etj.</p> <p>Nga intervistat e zhvilluara me personelin akademik dhe me studentët u mësua se sistemi SMS ishte gjerësisht i përdorur nga të dyja palët për të mirë koordinuar hapat gjatë semestrit,</p> <p>Evidenca 28. Udhezues i përdorimit të sistemit SMS.pdf</p>			
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e programit të studimit MPABKF në UMSH si edhe nga diskutimet e kryera me personelin akademik gjatë vizitës në Institucion, GVJ u informua se në mënyrë të përgjithshme procesi i përgatitjes së temave të diplomave që nga aplikimi deri tek dorëzimi i punimit dhe mbrojtja e temës, është i rregulluar në mënyrë të detajuar nëpërmjet një udhëzuesi të posaçëm i cili ishte në akses të lirë nga studentët. Departamenti në bashkëpunim me koordinatorin e programeve master cakton notën mesatare që shërben si kriter ndarës nëse studenti do përgatisë punim diplome apo do japë provim përfundimtar. Por sipas informacionit të marrë gjatë vizitës në Institucion u konstatua se për këtë vit akademik, të gjithë studentët e programit të studimit kishin zgjedhur përgatitjen e provimit të përgjithshëm, pra ky kriter nuk është relevant për vitin akademik 2021- 2022.</p> <p>Evidenca 7. Rregullore e programit MPABKF.pdf</p> <p>Evidenca 29. Udhezues për përgatitjen e punimit të Diplomes.pdf</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<p><b>Standardi III.4</b>  <b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV, GVJ konstaton ngritjen e një strukture të posaçme për promovimin e përmirësimit të vazhdueshëm. Sipas Statutit, dhe rregullores së funksionimit, UMSH ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave, NJSBCZHK. Kjo njësi harton një plan pune në koordinim me njësitë kryesore dhe njësitë bazë në funksion të arritjes së objektivave të saj</p>



kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	ndër të cilët është edhe promovimi i cilësisë në mësimdhënie. Njësia punon ngushtësisht me njësinë kryesore dhe njësinë bazë që janë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit. <a href="#">Evidenca 1. Statuti i UMSH.pdf</a> <a href="#">Evidenca 4. Rregullore e organizimit te UMSH.pdf</a>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Sipas Rregullores së Departamentit të Financë, Bankë, Kontabilitetit dhe Rregullores së programit të studimit MPABKF në UMSH, GVJ konstaton se departamenti është njësia bazë përgjegjëse për programet e studimit që ofron, që nga përzgjedhja e personelit akademik që angazhohet në mësimdhënie, pajisja e tyre me burimet e nevojshme përkatëse e deri tek shpërndarja optimale e ngarkesës mësimore dhe kontrolli i aktiviteteve të kryera nga stafi akademik. <a href="#">Evidenca 6. Rregullore e DFBK.pdf</a> <a href="#">Evidenca 7. Rregullore e programit MPABKF.pdf</a>
<b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	Nisur nga diskutimet e kryera gjatë vizitës në Institucion, për GVJ krijohet përshtypja se strukturat drejtuese dhe njësitë përgjegjëse të UMSH kanë një frymë inovatore dhe të hapur dhe janë pro prezantimit të metodave të reja inovative të mësimdhënies përsa kohë që këto metoda janë në funksion të përmbushjes së objektivave të të mësuarit.
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Nga informacionet e marra gjatë diskutimeve me personelin akademik të programit mësimor në vizitën në Institucion, GVJ u bë me dije se personeli akademik nxitet dhe mbështetet të publikojë në revista shkencore, të marrë pjesë në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe në projekte dhe trajnime që lidhen me fushën e tyre të kualifikimit. Edhe vetë Institucioni organizon konferenca shkencore me pjesëmarrjen e stafit të brendshëm. GVJ nuk konstaton megjithatë trajnime në fushën e kërkimit shkencor të stafit dhe të pyetur për këtë u informuan se në fakt trajnimet kryeshin kryesisht për stafin e ri pedagogjik. Sic u shprehën edhe pedagogët mbështetja për punën kërkimore në Institucion bëhet duke reduktuar ngarkesën mësimore dhe edhe duke financuar tarifat e publikimit dhe pjesëmarrjes në aktivitete shkencore. Universiteti ka prioritet botimet me faktor impakti. Vec kësaj ka pasur edhe konferenca të shumta të organizuara nga institucioni. Sipas deklaratave nga stafi akademik gjatë vizitës së kryes në Institucion, anëtarët e stafit akademik kanë si detyrim përgatitjen e dy artikujve shkencorë dhe pjesëmarrjen në dy konferenca shkencore në cdo vit akademik. Numri i saktë i artikujve dhe pjesëmarrjeve në konferenca, varion megjithatë në varësi të titullit, gradës dhe ngarkesës në mësimdhënie.
<b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Nga shqyrtimi i përmbajtjes së DVV si edhe nga bisedat me përfaqësues të institucionit gjatë vizitës, GVJ konstatoi se trajnimet e fundit lidhen me vitin akademik 2020 – 2021 pasi në vitin e fundit akademik nuk është punësuar personel i ri i cili të ketë nevojë për trajnime. Në mënyrë më specifike, për programin e studimit MPABKF janë të angazhuar PAE me tituj dhe grada dhe sipas qasjes institucionale (të shprehur gjatë vizitës në Institucion), nuk ofrohen trajnime për pedagogët me tituj dhe grada. <a href="#">Evidenca 24. Programi i trajnimeve 2020-2021.pdf</a>
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për	Nga informacionet e marra gjatë diskutimeve me personelin akademik të programit mësimor në vizitën në Institucion, GVJ formoi bindjen se personeli akademik shfrytëzon maksimalisht mundësitë e ofruara nga Institucioni për zbatimin e programeve të studimit dhe



përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	angazhohet për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja të mësimin.			
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Në RVB për këtë kriter specifikohet se pedagogët raportojnë në mënyrë semestrale dhe vjetore, raporte që përcillen pranë njësisë bazë dhe njësisë kryesore. Të pyetur për këtë, stafi u shpreh se ata raportojnë duke plotësuar formularë vetë vlerësimi. Këta formularë kanë disa seksione, të cilat plotësohen respektivisht nga pedagogët e më pas nga drejtuesit e njësisë kryesore dhe njësisë bazë.			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.	Në RVB për këtë kriter Institucioni raporton realizimin e disa leksioneve të hapura me lektorë të ftuar (evidenca 31). Gjatë vizitës në Institucion, GVJ kërkoi evidencë shtesë e cila u vu në dispozicion dhe në bazë të së cilës konkluduan që leksionet e hapura zhvillohen nga lektorë të ftuar nga biznesi dhe nga bota e praktikës. Leksionet e hapura dhe zhvillimi i tyre u konfirmuan edhe nga studentët gjatë bisedave më ta. Evidenca 31. Leksione te hapura ne programin MPABKF.pdf			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.5</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimin të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimin të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	GVJ konstatoi se mënyra e testimit të njohurive të studentëve përcaktohet në Rregulloren e Njësisë Bazë dhe në Rregulloren e programit të studimit MPABKF në UMSH. Mënyra e vlerësimin të njohurive të studentëve gjithashtu ishte përmbledhur në një udhëzues të posaçëm i cili pavarësisht se i përket vitit 2020 – 2021, GVJ gjykon se është evidencë e vlefshme pasi ka shërbyer si material orientues për studentët që kanë zgjedhur këtë program studimi. Shkalla e njohjes së studentëve me mënyrën e vlerësimin është gjithashtu e lartë pasi kjo ishte e përfshirë në programet lëndore të cilat u viheshin studentëve në dispozicion qysh në fillim të cdo semestri. <a href="#">Evidenca 6. Rregullore e DFBK.pdf</a> <a href="#">Evidenca 7. Rregullore e programit MPABKF.pdf</a> <a href="#">Evidenca 30. Udhëzues per studentet 2020-2021.pdf</a>
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimin të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga takimi me studentët e programit të studimit GVJ konstatoi se ata njihen në fillim të çdo lënde/moduli me elementet e lëndës, ndër të tjera edhe me metodologjinë e vlerësimin. Programet lëndore vendosen gjithashtu në dispozicion të studentëve që në fillim të semestrit nëpërmjet kanaleve të brendshme të komunikimit student / pedagog në klasat e menaxhuara në Google Classroom. <a href="#">Evidenca 8. Plan mesimor dhe syllabuse MPABKF.pdf</a> <a href="#">Evidenca 20. Udhëzues per provimin e ndermjetem, perfundimtar dhe te sezonit perserites.pdf</a>
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të	GVJ pasi shqyrtoi programet lëndore të disiplinave të programit të studimit MPABKF në UMSH, vërejtë se në to ka elemente të larmishme të kontrollit dhe vlerësimin të njohurive të studentëve si



demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	provimet dhe testimet e ndërmjetme dhe përfundimtare, detyrat e kursit dhe niveli i aktivizimit në seminare. GVJ gjykon se përfshirja e një larmie të formave të vlerësimit u jep mundësinë të gjithë studentëve të shprehin njohuritë dhe kompetencat e fituara në njërën ose disa prej formave të zgjedhura të testimit, të cilat për më tepër janë të shpërndara përgjatë semestrit. <u>Evidenca 8. Plan mesimor dhe syllabuse MPABKF.pdf</u>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>


### Standardi III.6

#### Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Nga analiza e programeve lëndore, GVJ ka konstatuar se vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm gjatë gjithë periudhës mesimore dhe vitit akademik dhe është rezultante e këtyre elementeve (përgjithësisht) të shtrira gjatë gjithë vitit akademik si testime gjatë vitit, detyrat e kursit, seminarët, pjesëmarrje aktive në mësim. Tabela 14 në anekset e RVB paraqet këto mënyra vlerësimi të njohurive për programin e studimit me peshat specifike përkatëse: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Pjesëmarrja aktive në mësim 10%</li> <li>2. Detyra e kursit 20%</li> <li>3. Testime gjatë vitit 30%</li> <li>4. Provimi përfundimtar 40%</li> </ol> Sipas nenit 61 të rregullores së organizimit të UMSH, provimet mund të jenë me shkrim, me gojë, ose të kombinuara.  <u>Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH.pdf</u> <u>Evidenca 10. Permbledhese e tabelave për programin MPABKF (1 deri 24).pdf</u>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në DVV, GVJ nuk hasi evidencë për përdorimin e sistemeve elektronike të vlerësimit as në përgjithësi në UMSH dhe as në programin e studimit MPABKF. Të pyetur gjatë vizitës në Institucion stafi u shpreh se ata kanë përdorur mjetet elektronike Google forms për korrigjimin e provimeve dhe detyrave të studentëve dhe kanë në plan implementimin e metodave elektronike të vlerësimit në të ardhmen e afërt.
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	GVJ shqyrtoi rregulloren e organizimit të UMSH dhe më specifikisht udhëzuesin e hartuar nga Institucioni për organizimin e provimeve duke konstatuar praktikën e hartimit të tezave nga titullari i lëndës dhe asistenti i tij. Sipas pikës 6 të udhëzuesit për provimet, nëse lënda ka vetëm një pedagog atëherë përgjegjësi i njësisë bazë cakton një pedagog tjetër mundësisht nga grup lënda për të formuar komisionin e provimit. Pra ky kriter përmbushet. <u>Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH.pdf</u> <u>Evidenca 20. Udhëzues për provimin e ndërmjetem, përfundimtar dhe të sezonit perserites.pdf</u>
<b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose	Bazuar në shqyrtimin e të dhënave në përmbajtje të DVV si edhe në konfirmimet e marra nga personeli akademik gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstatoi se testimet gjatë vitit dhe ato përfundimtare



<p>kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>në programin e studimit MPABKF në UMSH zhvillohen të monitoruara nga dy pedagogë dhe me procedurë sekretimi (nga sekretaria mësimore), duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korrigjuara në Sekretarinë Mësimore (Evidenca 20, pika 6). <u>Evidenca 20. Udhezues per provimin e ndermjetem, perfundimtar dhe te sezonit perserites.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Bazuar në udhëzuesin për provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare GVJ konstatoi se nga ana procedurale ishte parashikuar përfshirja e komenteve sqaruese dhe orientuese (me bojë të kuqe) për studentët në tabelën në fund të faqes së formatit. Në tezën e korrigjuar shënohet shuma e pikëve. Komentet sqarohen edhe me studentët në seancat e rishikimit të vlerësimit nëse këto të fundit kërkohen nga studentët.  <u>Evidenca 20. Udhezues per provimin e ndermjetem, perfundimtar dhe te sezonit perserites.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>GVJ konstatoi se në fund të cdo programi lëndor, tek seksioni “shënime të vecanta” pedagogët ishin kujdesur të vendosnin informacione dhe udhëzime të cilat bënin thirrje për respektim të ndershmërisë akademike dhe mos tolerim të palagjiaturës. Sipas rregullores së Fakultetit të Shkencave Ekonomike, konstatimi i plagjiaturës konsiderohet shkelje e rëndë dhe parashikon veprime dhe masa në përputhje me Kodin e Etikës së Institucionit duke filluar nga vërejtje me gojë e deri në përjashtim përgjithmonë nga UMSH, në varësi të shkallës së thyerjes. <u>Evidenca 5. Rregullore e FSHE.pdf</u> <u>Evidenca 8. Plan mesimor dhe syllabuse MPABKF.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Nga rregullorja e programit të studimit dhe nga bisedat me personelin akademik, GVJ u informua se shkalla e vlerësimit për cdo komponent vlerësimi gjatë vitit hidhet në Sistemin e Menaxhimit të Studentit në atë që njihet si procesverbali analitik online (këtu bëjnë pjesë pikët për frekuentimin dhe aktivizimin gjatë semestrit, për detyrat e kursit dhe për testimet gjatë vitit). Pesë ditë pas provimit përfundimtar aty hidhet edhe vlerësimi në provimin final duke mundësuar shpalljen në kohë të rezultateve. Provimet duhet të korrigjohen brenda tre ditëve kalendarike nga kryerja e provimit (udhëzuesi i provimeve, pika 6). Pedagogu e dorëzon listën në sekretarinë mësimore e cila bën c’sekretimin e tezave dhe ia dorëzon ato pedagogut brenda dy ditësh nga përfundimi i korrigjimeve. <u>Evidenca 20. Udhezues per provimin e ndermjetem, perfundimtar dhe te sezonit perserites.pdf</u> <u>Evidenca 7. Rregullore e programit MPABKF.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në UMSH, GVJ u informua se rishikimi aplikohet vetëm për provimet e ndërmjetme, përfundimtare dhe notën finale, por jo për vlerësimet e detyrave apo të angazhimit në seminare. Si rregull, shpallja e rezultateve bëhet 5 ditë pas zhvillimit të provimit në Sistemin e Menaxhimit të Studentit. Rishikimi mund të kryhej deri në 2 ditë pas shpalljes së notës në sistem, por para finalizimit të saj, pas së cilës nuk mund të kishte ndryshime të mëtejshme në vlerësim. Nëse studentin nuk bie dakord me vlerësimin e pedagogut atëherë ndiqet procedura e parashikuar për të rishikuar notën, sipas së cilës Dekani është autoriteti që merr vendimin për rishikimin e mëpasshëm. Studentët e programit të studimit u shprehën se gjatë këtij viti nuk kanë</p>





	<p>pasur kërkesa për rishikim vlerësimi pasi kanë qenë të bindur në saktësinë e vlerësimeve të tyre.</p> <p><a href="#">Evidenca 4. Rregullore e organizimit te UMSH.pdf</a></p> <p><a href="#">Evidenca 6. Rregullore e DFBK.pdf</a></p> <p><a href="#">Evidenca 30. Udhezues per studentet 2020-2021.pdf</a></p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Nëse pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të provimit studenti nuk është dakord me vlerësimin ai mund të bënte një ankesë me shkrim që dorëzohet në sekretarinë mësimore dhe ndiqet nga njësia përgjegjëse deri në sqarimin e studentit. Sipas RVB për këtë kriter, autoriteti përgjegjës për ndjekjen e procedurës së ankimit është Dekani i cili edhe përcakton nëse studenti ka të drejtë, rast në të cilin Dekani e shpall të pavlefshëm vlerësimin e parë të studentit dhe ose vendos që teza e studentit të rivlerësohet, ose që student të përsërisë provimin para një komisioni të posaçëm.</p> <p><a href="#">Evidenca 20. Udhezues per provimin e ndermjetem, përfundimtar dhe te sezonit perserites.pdf</a></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

### Standardi III.7

**Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Referuar shqyrtimit të dokumentacionit të DVV si edhe përshtypjeve dhe informacioneve të marra gjatë vizitës në Institucion, GVJ formoi opinionin se programi i studimit MPABKF në UMSH zhvillohet në mënyrë të tillë që u mundëson studentëve të thellojnë njohuritë e tyre dhe të zhvillojnë aftësi profesionale në këtë fushë të veçantë studimi me synim përgatitjen e profesionistëve të auditimit që kërkohen në tregun e punës në Shqipëri.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Nga shqyrtimi i Plani Mësimor dhe i programeve lëndore të MPABKF në UMSH, GVJ konstatoi se ka disa lëndë dhe tema të cilat trajtojnë elemente të sistemeve të informatizuara, në përshtatje kjo me zhvillimet e këtij profesioni vitet e fundit. Plani Mësimor përmban gjithashtu lëndën e Etikës e cila synon të zgjojë tek studentët ndërgjegjësimin për dimensionin human e social të profesionit të kontabilistit dhe audituesit në përputhje kjo edhe me Standardet Ndërkombëtare të Edukimit në profesionin përkatës. <i>Megjithatë, sugjerimi dhe opinioni i GVJ është që lënda e Sistemeve të Informacionit dhe Kultura Digitale ka nevojë të pasurohet me tema që kanë fokusin specifik në auditimin e IT apo kontrollet e brendshme në sistemet e informatizuara, që do të mundësonin një përshtatje edhe më të madhe me fokusin e programit të studimit.</i></p> <p><a href="#">Evidenca 8. Plan mesimor dhe syllabuse MPABKF.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>GVJ konstatoi se të gjitha programet lëndore të Programit të Studimit, MPABKF në UMSH, kanë të përfshira “Rezultatet e të nxënimit nga studentët”, kjo në përputhje edhe me kërkesat e VKM nr.41 të ndryshuar. Ky element liston përfitimet e pritshme nga cdo lëndë e</p>



	<p>programit për të mbërritur në përmbushjen e objektivave të programit të studimit.</p> <p>Evidenca 8. Plan mesimor dhe syllabuse MPABKF.pdf</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>Sipas RVB për këtë kriter, në fund të cdo semestri pedagogët zhvillojnë një seancë të vecantë me përmbledhje të njohurive kryesore të lëndës dhe peshën respektive të tyre në provimin përfundimtar.</p> <p>Gjithashtu, GVJ konstatoi se në disa prej programeve lëndore tema e fundit në javën e fundit të semestrit i dedikohet përsëritjes së njohurive pikërisht në funksion të analizës së kompetencave dhe aftësive të fituara nga studenti. Të pyetur gjatë vizitës në Institucion, studentët e programit të studimit e konfirmuan këtë praktikë.</p> <p>Evidenca 8. Plan mesimor dhe syllabuse MPABKF.pdf</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e DVV, si edhe në informacionet e marra nga përfaqësues të Institucionit gjatë vizitës, GVJ konstatoi se UMSH organizon prezantime dhe leksione të hapura për tematika të ndryshme, ku nuk mungonin mbulimi i çështjeve që kanë të bëjnë me zhvillimet teknologjike dhe shkencore. Informacioni në DVV në lidhje me këtë pikë i referohej vitit të mëparshëm akademik 2020 - 2021.</p> <p><a href="https://www.umsh.edu.al/c/218/aktivitete-te-tjera">https://www.umsh.edu.al/c/218/aktivitete-te-tjera</a></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Mbështetur në Planin Mësimor dhe në përmbajtjen e programeve lëndore të programit të studimit MPABKF në UMSH, por edhe nga informacionet marrë gjatë vizitës në Insticion, GVJ konstaton se ky program studimi nuk parashikon shfrytëzimin e orëve në laborator. Kurse praktika profesionale është një detyrim akademik që duke u kryer në pozicione pune sa më pranë fushës së studimit të programit, u jep mundësinë studentëve të zhvillojnë njohuritë teorike të marra në auditor.</p> <p>Evidenca 8. Plan mesimor dhe syllabuse MPABKF.pdf</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Nga diskutimet me personelin akademik të angazhuar në programin e studimit MPABKF, GVJ formoi përshtypjen se ata ishin të hapur dhe mbështetës për dinamikën e punës në grup sidomos në këtë program specifik në nivelin e dytë të studimeve. Sipas tyre, kombinimi i studentëve në grupe pune për detyrat dhe projektet e kursit pasuron diskutimet dhe këndvështrimet në ekip dhe mundëson zgjidhjen e problematikave në mënyra inovatore dhe të integruara sidomos duke pasur parasysh se studentët vijnë nga pozicione të ndryshme pune cka pasuron shkëmbimin e njohurive dhe informacionit.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>	<p>Nga diskutimet me personelin akademik të angazhuar në programin e studimit, GVJ konstatoi se ata operojnë në një ambient të hapur për implementimin e ideve inovatore dhe u kërkohet të inkurajojnë edhe përfshirjen e studentëve, sidomos atyre të ciklit të tretë, dhe të ciklit të dytë Master i Shkencave, në punën kërkimore shkencore. Por programi mësimor MPABKF është Master Profesional cka limiton, por nuk ndalon plotësisht përfshirjen e studentëve në projektet kërkimore shkencore. Megjithatë, GVJ konstatoi se asnjë student i këtij program studimi nuk ishte përfshirë në studime të avancuara kërkimore dhe shkencore pavarësisht mundësive të krijuara nga personeli akademik.</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Nga RVB, GVJ informohet se fokusi i programit të studimit MPABKF në UMSH është zhvillimi i sensit praktik tek studentët por kjo nuk i pengon ata të bëjnë punë të thelluara kërkimore. RVB deklaroi se Institucioni organizon workshope dhe konferenca ku studentët inkurajohen të marrin pjesë. <i>Por nuk ka evidencë për mbështetje</i></p>



	<i>financiare të ideve inovatore dhe studimeve të avancuara të studentëve dhe kjo pikë nuk u përmend as gjatë vizitës në Institucion.</i>			
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Nga shqyrtimi i DVV, GVJ konstaton angazhimin në Fakultetin e Shkencave Ekonomike si PAK, emra të njohur për ekspertizën e tyre në fushat përkatëse, pavarësisht se këta profesorë nuk anagazhohen drejtpërdrejt në programin e studimit MPABKF. Gjithashtu në RVB Institucioni shprehet për analizën e marrëveshjeve të bashkëpunimit në mënyrë që të shfrytëzohen maksimalisht aktorët e biznesit në funksion të rritjes së mobilitetit të studentëve. <i>Evidenca 15. Memo mbi bashkëpunimin me bizneset.pdf</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi III.8

#### Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Sipas RVB, Departamenti i Financë, Bankë Kontabilitetit, që është njësi përgjegjëse që e ofron këtë program studimi përmes bashkëpunimit me aktorë të rëndësishëm të tregut të punës, garanton mundësitë e nevojshme për realizimin e praktikës profesionale pranë institucioneve pritëse duke vendosur në dispozicion të studentëve listën e Institucioneve me të cilët UMSH ka marrëveshje bashkëpunimi. UMSH ka specifikuar kriteret të cilat duhet të plotësohen nga Institucionet pranë të cilave studentët e programeve të UMSH orientohen për të realizuar praktikat mësimore (udhëzuesi për praktikën, pika 8). Megjithatë, sikurse u përmend më lart në këtë raport, për këtë program studimi, për vitin akademik 2020 -2021, praktikat janë kryer në pozicionet përkatëse të punës së cdo student duke qenë se ata ishin kryesisht të punësuar në pozicione në financë, ekonomi. <i>Evidenca 32. Udhëzues për praktikën (Bachelor, Master).pdf</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi.
<b>Kriteri 3.</b> Praktikën profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Referuar Planit Mësimor të MPABKF në UMSH, praktika profesionale ka 6 kredite në programin e studimit. Sipas udhëzuesit për praktikën (pika 5.7) dhe nga informacionet e marra gjatë vizitës në Institucion, GVJ u informua se për mbikëqyrjen e praktikave profesionale Departamenti cakton një pedagog përgjegjës i cili kontrollon të gjitha vizitat e studentëve nëpër Institucione. Në përfundim të zhvillimit të praktikave profesionale, pedagogu që e mbikëqyr studentin gjatë praktikës dorëzon formularin e vlerësimit të studentit. Më pas vlerësimi përfundimtar i studentit bëhet përpara një komisioni. <i>Evidenca 8. Plan mesimor dhe syllabuse MPABKF.pdf</i> <i>Evidenca 32. Udhëzues për praktikën (Bachelor, Master).pdf</i>



Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

### Standardi III.9

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.**



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Referuar dokumentacionit në DVV, GVJ konstaton se janë paraqitur në mënyrë të detajuar procedurat që ndiqen për përgatitjen për provimin e përgjithshëm ose për temën e diplomës. Nga bisedat e zhvilluara me studentët e programit të studimit GVJ konstaton se ky informacion i vihet në dispozicion edhe studentëve përpara fillimit të përgatitjes së tyre për diplomim.</p> <p><u>Evidenca 33. Udhezues per provimin e formimit.pdf</u>  <u>Evidenca 29. Udhezues per pergatitjen e punimit te Diplomes.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Sipas udhëzuesve përkatës dhe në bazë edhe të konstatimeve në vizitën në Institucion personeli akademik asiston studentët në procesin e diplomimit përmes seancave metodologjike. Sipas këtyre udhëzuesve, për studentët që përgatisin punim diplome, pedagogu udhëheqës i udhëzon për fushën e përgatitjes së punimit, strukturën, metodologjinë, i orienton studentët drejt literaturës që ata duhet të shqyrtojnë, u jep udhëzime dhe materialet e nevojshme për përfundimin me sukses të temës.</p> <p>Studentët që i nënshtrohen provimit të përgjithshëm orientohen në lidhje me literaturën që duhet të shfletojnë, si edhe u zhvillohen në klasë raste studimore të ngjashme, me qëllim që të familjarizohen me këtë formë testimi. GVJ u vu në dijeni që studentëve u ishte vënë në dispozicion një material orientues për përgatitjen për provim të përgjithshëm.</p> <p><u>Evidenca 33. Udhezues per provimin e formimit.pdf</u>  <u>Evidenca 29. Udhezues per pergatitjen e punimit te Diplomes.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Mbështetur në udhëzuesin për provimin e formimit dhe në informacionet e marra gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstaton se për programin e studimit MPABKF në UMSH, provimi i përgjithshëm i formimit reflekton tematika nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit. Ai përmban 40% pyetje të formimit të përgjithshëm dhe 60% pyetje sipas specifikave të programit të studimit. Teza duhet t'i përmbahet strukturës së pyetjeve të syllabuseve të lëndës, literaturës bazë dhe asaj ndihmëse. GVJ u vu në dijeni që studentëve u ishte vënë në dispozicion një material orientues për përgatitjen për provim të përgjithshëm, material që u kërkua dhe u vu në dispozicion të GVJ nga Institucioni</p> <p><u>Evidenca 33. Udhezues per provimin e formimit.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.</p>	<p>Nga informacionet e marra nga udhëzuesi për përgatitjen e temës së diplomës GVJ konstaton se pedagogu udhëheqës e orienton dhe e ndihmon studentin jo vetëm në fillim për përcaktimin e temës së diplomës, por edhe gjatë punës dhe zhvillimit të temave duke zhvilluar seanca metodologjike orientuese me grupin e studentëve që ai udhëheq. Pedagogët nuk mund të udhëheqin më shumë se 10 studentë të nivelit master cdo vit, për të garantuar cilësinë e këtij procesi.</p>



	Megjithatë, ky kriter nuk gjen zbatim për programin e studimit MPABKF për vitin akademik 2021 – 2022 pasi të gjithë studentët kishin zgjedhur të diplomohen nëpërmjet provimit të përgjithshëm. <u>Evidenca 29. Udhezues per pergatitjen e punimit te Diplomes.pdf</u>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Sipas dokumentacionit në DVV, pedagogu udhëheqës së bashku me njësinë bazë përgjegjëse për programin e studimit garantojnë asistencën e studentit gjatë fazës së kryerjes së matjeve, analizave apo testeve të ndryshme. Megjithatë të pyetur gjatë vizitës në Institucion GVJ kupton që kjo deklaratë në RVB nuk përputhet me realitetin për këtë program studimi pasi asnjë student nuk kishte zgjedhur të diplomohet me punim diplome, por me provim të përgjithshëm formimi. <u>Evidenca 29. Udhezues per pergatitjen e punimit te Diplomes.pdf</u>			
<b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Sipas dokumentacionit në DVV, pedagogët udhëheqës organizojnë seanca këshillimore përgjatë gjithë procesit të përgatitjes së temës së diplomës (gjithsej 15 javë nga të cilat studentët janë të detyruar të ndjekin të paktën 50% të tyre). Qëllimi i këtyre seancave është orientimi i studentëve gjatë punës së tyre. GVJ konstaton që për këtë vit studimi, të gjithë studentët e programit kishin zgjedhur të diplomohen me një provim të përgjithshëm formimi dhe nuk mund të shprehet për këtë kriter. <u>Evidenca 29. Udhezues per pergatitjen e punimit te Diplomes.pdf</u>			
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Referuar udhëzuesit për përgatitjen e punimit të diplomës, por edhe gjatë vizitës në Institucion GVJ informohet se provimi përfundimtar i formimit dhe punimi i diplomës vlerësohen me notë, e cila është mesatare e vlerësimit të anëtarëve të komisionit të vlerësimit. Rezultati përfundimtar shënohet në Procesverbal dhe bëhet publik në fund të çdo seance të mbrojtjes së diplomave, në prani të studentëve. <u>Evidenca 29. Udhezues per pergatitjen e punimit te Diplomes.pdf</u>			
<b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	GVJ konstatoi se në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Format i diplomës dhe i suplementit gjenden si pjesë e DVV të shqyrtuar nga GVJ. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore të Institucionit, GVJ konfirmoi këto procedura. <u>Evidenca 34. Modeli i diplomes dhe suplement i MPABKF.pdf</u>			
<b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Sipas Rregullores së programit të studimit MPABKF në UMSH dhe rregullores së sekretarisë mësimore (neni 15), GVJ informohet se studentit ka të drejtë të kërkojë e t'i vihet në dispozicion një kopje zyrtare e programit të studimit të zhvilluar e cila i jepet e firmosur dhe e vulosur. <u>Evidenca 7. Rregullore e programit MPABKF.pdf</u> <u>Evidenca 36. Rregullore e sekretarise mesimore.pdf</u>			
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.	Gjatë vizitës në Institucion, GVJ pati mundësinë që të kërkonte informacione për studentët pranë sekretarisë mësimore dhe konfirmon përmbushjen e kërkesave për informacion të paraqitura nga ana e tyre. Sekretaria mban në mënyrë të rregullt informacionet për studentët si të dhëna të përgjithshme, evidenca per notat dhe vlerësimet, etj.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>



Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht





**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,  
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Institucioni në organikën e tij ka ngritur Zyrën e Burimeve Njerëzore. Zyra e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programin e studimit me kohë të plotë dhe me kontratë. Veprimtaria e zyrës mbështetet në Rregulloren e Organizimit të UMSH (<i>Evidenca Nr. 4, neni 37</i>). Gjatë takimit me personilin e Zyrës së Burimeve njerëzore, GVJ konstatoi se kjo zyrë dispononte të dhëna mbi anëtarët e personelit akademik dhe ndihmës akademik të angazhuar në organizimin e programeve të studimit që ofron ky institucion.</p> <p>Departamenti përgjegjës ruan të dhënat mbi personelin akademik të angazhuar në programin e studimit lidhur kualifikimin, shpërndarjen e ngarkesës mësimore etj.</p> <p>Zyra e Burimeve Njerëzore plotëson, ruan dhe përditëson dosjet personale të personelit. Në mënyrë rastësore, GVJ shqyrtoi dosjen personale të dy pedagogëve të programit të studimit dhe konstatoi se dosja ishte e plotësuar me dokumentet e nevojshëm si: CV, Vërtetimin nga gjykata, dokumentin e Diplomës, dokumentet e gradave/titujve shkencorë, vërtetime mbi kualifikimin, kontratën e punës, librezën shëndetësore, si edhe raportin e vlerësimit të performancës së pedagogut.</p> <p><i>GVJ sugjeron që një pjesë e CV të përditësohen.</i></p> <p><u><i>Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH.pdf</i></u></p>
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Rregullorja e organizimit të UMSH (neni 39) përcakton procedurat e rekrutimit dhe angazhimit të personelit akademik. Neni 57 i Statutit të UMSH përcakton si kritere punësimi të stafit akademik: 1) Të mbajë të paktën gradën Doktor ose të ketë së paku kualifikimi e ciklit pasardhës; 2) të ketë përvojë pune jo më pak se 5 vjet. GVJ konstaton se personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi mban të paktën gradën shkencore Doktor, pra plotëson kriterin e përcaktuar në aktet lidhore dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p> <p>Njësia bazë çdo semestër dhe vit akademik evidenton nevojat e departamentit për personel akademik dhe ia bën të ditur dekanit. Dekani pas shqyrtimit të nevojave të fakultetit, i propozon numrin e vendeve vakant Rektorit për miratim. Më pas bëhet shpallja e vendeve vakante dhe kritereve specifike (që përcaktohen nga njësia bazë) në faqen e internetit të institucionit, në rrjetet sociale dhe në disa raste në media. Aplikantët e dorëzojnë dokumentacionin pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe komisioni ad-hoc i ngritur nga rektori bën përzgjedhjen e kandidatëve në dy faza: fillimisht në varësi të plotësimit të kritereve, përgatit listën e kandidatëve që do të</p>



	<p>paraqiten për intervistë dhe më pas përzgjedh kandidatët në bazë të intervistës. Komisioni harton raportin dhe i paraqet për miratim Rektorit kandidatet. Me miratimin nga Rektori fillon procedura e punësimit të kandidatit.</p> <p><u>Evidenca 1. Statuti i UMSH.pdf</u> <u>Evidenca 37. Përmbledhje e procedurës së rekrutimit.pdf</u></p>								
<p><b>Kriteri 3</b> Institucioni i arsimit të lartë harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, procedurat e rekrutimit të stafit akademik dhe kriteret e përgjithshme përcaktohen në statutin e UMSH dhe në rregulloren e Organizimit të UMSH (nenit 38 dhe 39).</p> <p><u>Evidenca 1. Statuti i UMSH.pdf</u> <u>Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH.pdf</u></p>								
<p><b>Kriteri 4</b> Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Procedurat e rekrutimit dhe vlerësimit të personelit akademik përcaktohen në Statutin e UMSH dhe ndiqen nga Zyra e Burimeve Njerëzore. Departamenti pas një analize të hollësishme të kapaciteteve dhe ngarkesave konstaton nevojën për personel të ri akademik, i paraqet propozimin për rekrutim të personelit akademik Dekanit, i cili ia paraqet Rektorit. Propozimi përmban profilin profesional të personelit akademik, që propozohet të rekrutohet, argumentimin e këtij propozimi, si dhe në varësi të ngarkesës që pritet të mbulojë, nëse nevojitet pedagog efektiv apo i ftuar, sipas vendeve vakante në departament. Në këtë mënyrë përzgjedhja e personelit bëhet në përputhje me kriteret e përgjithshme por edhe specifike që lidhen me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Niveli i përmbushjes</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;"><b>X</b></td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				<b>X</b>
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			<b>X</b>						

<b>Standardi IV.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>UMSH angazhohet që ti sigurojë personelit akademik dhe personelit ndihmës kushte dhe mjedise pune të përshtatshme për kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë profesionale.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor (salla leksioni, seminari, laboratorë etj) dhe zyra të përshtatshme për kryerjen e detyrave të ndryshme administrative.</p> <p><u>Evidenca 10. Përmbledhëse e tabelave për programin MPABKF.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, si nga takimi me Dekanin dhe Përgjegjësin e programit të studimit, edhe nga takimi me pedagogë të këtij programi studimi, GVJ iu confirmua angazhimi nga institucioni për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon programin e studimit MPABKF. Pedagogët e angazhuar në këtë</p>



	<p>program studimi kanë marrë pjesë në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, kanë botuar atikuj në revista shkencore, madje gjatë takimit me personelin akademik të programit të studimit, konfirmuan që një pjesë e tyre ishin financuar nga institucioni për pjesëmarrje në konferenca dhe botim artikujsh.</p> <p>UMSH ka organizuar disa Konferenca në bashkëpunim edhe me institucione të tjera dhe boton një reviste periodike Euromediterranean, nëpërmjet të cilave i mundësohet personelit akademik të publikojë punën kërkimore-shkencore. Informacioni mbi konferencat dhe revistën e institucioni është i aksesueshëm në faqen zyrtare të internetit të institucionit.</p>								
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Institucioni inkurajon përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies dhe të teknologjive të reja për të rritur cilësinë e procesit mësimor dhe kualifikimin shkencor të personelit akademik.</p> <p><u>Evidenca 21. Udhëzues mbi përdorimin e platformave të mësimi online.pdf</u></p>								
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Angazhimi i burimeve njerëzore nga institucioni, duke marrë parasysh si kualifikimin shkencor të tij edhe ngarkesën mësimore, bëhet në drejtim të përmbushjes së objektivave të programit të studimit MPABKF.</p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p><b>Standardi IV.3</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion u konstatua se Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse. UMSH ushtron veprimtarinë në një godinë pesë katëshe të marrë me qera dhe në katin e dytë të një godine dykateshë në pronësi. Sipas dokumentacionit bashkëngjitur RVB, veprimtaria e mësimdhënies zhvillohet në 6 salla leksioni me sipërfaqe totale 563.5m<sup>2</sup> dhe 1515 vende, 15 salla seminari, me sipërfaqe 398.1m<sup>2</sup>, 1 sallë për aktivitete promovuese, 5 laboratorë, 4 salla për bibliotekë, zyra për personelin akademik dhe ndihmës akademikë dhe ambjente të tjera shërbimi në funksion të procesit mësimor dhe punës kërkimore shkencore. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ konfirmoi se institucioni siguron mjediset të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor.</p> <p><u>Evidenca 26. Relacion i verifikimit të godinës.pdf</u>  <u>Evidenca 10. Përmbledhëse e tabelave për programin MPABKF.pdf</u></p>



<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ vizitoi disa salla leksionesh dhe seminaresh, laboratorët, bibliotekën dhe mjedise të tjera dhe vuri re që mjediset mësimore ishin të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit si PC, projektorë dhe sistem fonie si dhe kanë ndriçim optimal për kryerjen e veprimtarisë mësimore.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Sallat ku zhvillohet mësimi i programit të studimit MPABKF janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit si PC, projektorë dhe pajisje fonie. UMSH ka dy laboratorë për lëndët dhe tre laboratorë informatike të pajisur me aparaturat dhe mjetet e nevojshme. Nga shqyrtimi i planit mësimor GVJ konstaton se nuk është parashikuar ndonjë orë laboratorike për programin e studimit. Gjithashtu nga takimi me studentët, GVJ iu komunikua se studentët e këtij program studimi nuk e kanë parë të nevojshme frekuentimin e laboratorëve.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.</p>	<p>Institucioni ka dy laboratorë informatike, të pajisur me programe profesionale, si programet e kontabilitetit Alfa, Financa 5 si edhe SPSS dhe programin Business English, të cilët mund të përdoren nga studentët për punimin e detyrave/projekteve të kursit. Nga shqyrtimi i planit mësimor GVJ konstaton se nuk është parashikuar ndonjë orë laboratorike për programin e studimit. Gjithashtu nga takimi me studentët, GVJ iu komunikua se studentët e këtij program studimi nuk e kanë parë të nevojshme frekuentimin e laboratorëve.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike</p>	<p>Për realizimin e praktikës profesionale UMSH ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme, të cilët u garantojnë dhe ofrojnë mjediset e tyre studentëve për plotësimin e kërkesave të moduleve dhe asimilimin e njohurive teorike dhe praktike nga studentët e këtij program studimi. Meqënëse sikurse u konfirmuar nga vizita në institucion, studentët e këtij programi studimi janë në marrëdhënie pune, ata e kanë kryer praktikën pranë vendit të punës ku punojnë. <a href="#">Evidenca 11. Marrëveshje bashkëpunimi.pdf</a></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.**

<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sipas RVB UMSH disponon katër salla biblioteke dhe një sallë interneti të cilat kanë një sipërfaqe totale prej prej 209m<sup>2</sup>. Gjatë vizitës GVJ konstatoi se vetëm një sallë plotësonte kushtet dhe standartet e një biblioteke. Biblioteka është e pajisur me sistem ngrohje-ftohje</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

46



	dhe ndriçim optimal dhe ofron të gjithë infrastrukturën e nevojshme për akomodimin dhe shfrytëzim optimal nga studentët e të gjithë programeve të studimit. <u>Evidenca 10. Përmbledhëse e tabelave për programin MPABKF.pdf</u> <u>Evidenca 39. Informacion mbi infrastrukturën e UMSH.pdf</u>			
<b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Gjatë vizitës në ambjentet e bibliotekës dhe informacioni i marrë, GVJ konstatoi se biblioteka ishte e pasur me literaturë fizike – rreth 4.240 tituj librash dhe revistash shkencore (sipas RVB) në fusha të disiplinave të ndryshme të nevojshme në mbështetje të këtij programi studimi dhe të programeve të tjera të FSHE si: tekste mësimore bazë në gjuhën shqipe; tekste mësimore dhe materiale ndihmëse në gjuhë të huaj; libra, revista dhe botime të institucioneve të tjera. GVJ konstatoi se në bibliotekë gjendeshin kopje të teksteve të literaturës së këtij programi studimi dhe leksione të pedagogëve të këtij program studimi. Institucioni ka krijuar edhe një bibliotekë elektronike ku janë ngarkuar 17.003 tituj librash në format elektronik të aksesueshëm pa pagesë nga studentët dhe stafi akademik.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Gjatë takimit me studentët e këtij programi na u konfirmua se ata kanë mundësi të përdorin pa pagesë si literaturën fizike të disponueshme në bibliotekë edhe bibliotekën elektronike, megjithse kryesisht studentët mjaftoheshin me përdorimin e materialeve që pedagogët ngarkonin në Classroom. Gjatë vizitës në bibliotekë, GVJ iu konfirmua se institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik bibliotekën elektronike si Edward Elgar Publishing dhe Cobiss.			
<b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Bibliotekës dhe sallat e leximit kanë internet dhe janë të pajisura me kompjutera që kanë të instaluar programe që u mundësojnë studentëve aksesin në bibliotekën elektronike.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Institucioni nxit njësinë bazë dhe kryesore të përditësojë fondin ekzistues të literaturës së programit të studimit. Gjatë takimit me personelin akademik të programit të studimit, pedagogët u shprehën se institucioni i plotëson kërkesat e tyre për literaturën që ata e vënë në shërbim të programit të studimit. Kjo literaturë mund të jetë fizike në bibliotekë, ose në formatin pdf të ngarkuar në bibliotekën online të krijuar nga UMSH.			
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	Sipas RVB biblioteka është e hapur në orare duke iu përshtatur edhe orareve të zhvillimit të procesit mësimor. Orari i bibliotekës është i shpallur në hyrje të saj.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>



**Standardi IV.5**

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin në programin e studimit.</p>	<p>Që në vitin 2017, UMSH ka ngritur dhe ka aktualisht funksional një sistem të menaxhimit të informacionit SMSUMSH i cili është i aksesueshëm nga personeli akademik dhe ndihmës-akademik dhe studentët. Sekretaria Mësimore ruan në hard-copy dhe elektronikisht të gjitha të dhënat e studentëve që nga regjistrimi i tyre, vlerësimin me nota dhe deri në diplomimin e tyre.</p> <p><u>Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH.pdf</u>  <u>Evidenca 36. Rregullore e sekretarisë mësimore.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës-akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Dokumentacioni dhe aktiviteti i personelit akademik, personelit ndihmës akademik, administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit të studimit ruhet elektronikisht dhe në hard copy sipas përcaktimeve në rregulloren e UMSH dhe FSHE: në departament, fakultet dhe në rektorat. Sistemi elektronik i informacionit aksesohet nga përdoruesit përmes faqes zyrtare të internetit të UMSH.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit të informacionit është i ndarë në dy pjesë: pjesa e dedikuar studentëve dhe pjesa e dedikuar stafit akademik dhe ndihmës-akademik. Në këtë mënyrë secila palë nga akses në çdo kohë në sistem.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Platforma SMSUMSH u mundëson studentëve të marrin informacion mbi çështjet financiare, administrative dhe vlerësimin e tyre gjatë dhe në përfundim të moduleve. Gjatë vizitës në institucion GJVJ iu konfirmua se përdorimi i platformës Classroom u mundëson studentëve të komunikojnë si individualisht edhe në grup me pedagogët, ku përveç komunikimit dhe shkëmbimit të materialeve mësimore mund të përfshihen edhe në diskutime online në grup.</p> <p>Linku: <a href="http://login(umsh.edu.al)"><u>Logjin (umsh.edu.al)</u></a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Sipas RVB dhe sic u konfirmua edhe nga takimi me studentët dhe personelin e institucionit, nëpërmjet sistemit elektronik të menaxhimit të informacionit bëhet raportimi në kohë reale në nivel individit dhe njësie përgjegjëse.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe</p>	<p>Faqja zyrtare e institucionit përmban informacion kryesor në lidhje me Universitetin: filozofinë dhe misionin, fakultetet dhe programet e studimit që ofrohen në nivelin e parë dhe të dytë të studimeve, senatin akademik, stafin drejtues, bordin administrativ, drejtimin dhe funksionimin, organigramën, projektet dhe bashkëpunimet, kërkimin shkencor, studenët dhe rrjetin alumni, konferencat, revistat di dhe aktivitete të ndryshme që lidhen me aktivitetin mësimor dhe kërkimor.</p> <p>Sipas RVB faqja zyrtare përmban informacion të plotë mbi guidat për studentët e ardhshëm të Universitetit si dhe mbi programet dhe syllabuset e lëndëve.</p>



	Nga shqyrtimi i faqes zyrtare online të UMSH, lidhur me programin e studimit MPKAB, informacioni që paraqitet nuk është shumë i saktë: në formularin e aplikimit mungon ky program studimi si dhe orari për këtë program studimi. Gjatë vizitës në institucion GVJ iu komunikua se faqja zyrtare e internetit të institucionit është në proces riorganizimi. Informacioni në faqen e internetit të UMSH është vetëm në gjuhën shqipe.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

#### Standardi IV.6

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Sipas dokumentacionit të bashkëngjitur RVB administratori i UMSH harton çdo vit projekt buxhetin në bazë të propozimit të njësisve bazë dhe kryesore, përcakton kriteret për shpenzimin e burimeve financiare dhe materiale dhe ia dërgon Bordit të Administrimit për miratim. Këto funksione të Administratorit janë të përcaktuara në nenin 45 të Statutit të UMSH. Informacioni financiar i bashkëngjitur dokumentacionit të RVB i referohet institucionit dhe jo programit të studimit. <u>Evidenca 1. Statuti i UMSH.pdf</u> <u>Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH.pdf</u> <u>Evidenca 10. Përmbledhëse e tabelave për programin MPABKF.pdf</u>
<b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologji mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zërit të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.	Të dhënat financiare institucionale të programuara dhe faktike janë dokumentura për tre vitet e fundit duke evidentuar të ardhurat që vijnë nga studentët dhe nga projektet si dhe shpenzimet administrative, për paga dhe për kërkim shkencor, dhe shpenzime për investime dhe teknologji. Sipas Tabelës nr. 19 bashkëngjitur dokumentacionit të RVB, 94,83% e të ardhurave të institucionit vijnë nga kontributet e studentëve dhe 1.64% nga projektet. Lidhur me përdorimet, 62% shkon për mbulimin e pagave, 1,45% për kërkim shkencor dhe 6,65% për investime dhe teknologji. <i>GVJ sugjeron që UMSH si një institucion arsimor kërkimor-shkencor të alokojë një shumë më të madhe për kërkimin shkencor.</i> Lidhur me të ardhurat nga projektet aktualisht raportohen të ulta, por gjatë takimit me drejtuesen e Zyrës së projekteve, GVJ konstatoi një përpjekje dhe angazhim maksimal të tyre për tu përfshirë dhe fituar projekte kombëtare dhe ndërkombëtare. <u>Evidenca 10. Përmbledhëse e tabelave për programin MPABKF.pdf</u>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin	Sipas RVB UMSH kryen auditim të pasqyrave financiare çdo vit nga kompani auditimi e certifikuar, sipas së cilës pasqyrat financiare dhe të gjitha rregjistrimet janë kryer në përputhje me standartet



financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifatat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	Kombëtare të Kontabilitetit në Shqipëri dhe garantohet qëndrueshmëria financiare e institucionit. GVJ nuk ka në dispozicion këtë raport. Raporti vjetor (Evidenca nr. 39) të cilit i referohet RVB nuk ka lidhje me raportimin financiar.			
<b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Sipas RVB, administratori ka të drejtë të kontrollojë dhe rregullojë ndryshimet në buxhetin e institucionit duke ndjekur procedurat e përcaktuara në Statut dhe Rregulloren e Organizimit të UMSH. Zyra e Financë Kontabilitetit është përgjegjëse për monitorimin dhe zbatimin e politikës financiare. GVJ nuk ka në dispozicion raportin financiar për tre vitet e fundit.  <u>Evidenca 1. Statuti i UMSH.pdf</u> <u>Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH.pdf</u>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	Pavarësisht se GVJ kërkoi informacion më të detajuar mbi performancën financiare të institucionit, si edhe raportin e auditimit të jashtëm që do të mundësonin që GVJ të shprehë opinion në lidhje me shkallën e përmbushjes së këtij kriteri, këto dokumente nuk iu vunë në dispozicion. Për këtë arsye GVJ nuk mund të shprehet mbi qëndrueshmërinë financiare të institucionit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
		X		

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqërues dhe në informacionin e marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ konkludon se politikatat dhe procedurat që mbulojnë ciklin akademik të studentëve të programit të studimit MPABKF janë në përputhje me planin strategjik të UMSH, rregulloren e FSHE dhe rregulloren e programit të studimit MPABKF.  <u>Evidenca 2. Plani strategjik i zhvillimit të UMSH.pdf</u> <u>Evidenca 3. Strategjia e zhvillimit të programit MPABKF.pdf</u>





<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH.pdf</p> <p>Rregulloret e njësive kryesore dhe bazë dhe rregullorja e programit të studimit parashikojnë qartë kriteret dhe procedurat e përgjithshme të pranimit të studentëve në programet e ciklit të dytë, si dhe procedurat lidhur me ecurinë deri në diplomim, përfshirë vlerësimin e dijeve dhe mundësinë e transferimit në programe të tjera.</p> <p>Evidenca 5. Rregullore e FSHE.pdf</p> <p>Evidenca 6. Rregullore e DFBK.pdf</p> <p>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MPABKF .pdf</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e përgjithshme të pranimit të studentëve në programet e ciklit të dytë, si dhe procedurat lidhur me ecurinë deri në diplomim, përfshirë dhe mundësinë e transferimit në programe të tjera janë përcaktuar qartë jo vetëm në rregulloret e njësive kryesore, bazë dhe të programit të studimit por janë të afishuara dhe lehtësisht të aksesueshme nga publiku edhe në faqen zyrtare të internetit të institucionit.</p> <p>Në takimin me studentët e këtij programi studimi, GVJ konstatoi se procedurat dhe kriteret e përdorura në përzgjedhjen e studentëve, në vlerësimin përgjatë ciklit të studimeve e më pas, deri në diplomim, janë lehtësisht të kuptueshme dhe të disponueshme për të gjithë të interesuarit.</p> <p>Evidenca 5. Rregullore e FSHE.pdf</p> <p>Evidenca 6. Rregullore e DFBK.pdf</p> <p>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MPABKF .pdf</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p>Institucioni harton çdo vit akademik kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve për tu pranuar në ciklin e dytë të studimeve dhe i publikon ato në faqen zyrtare të institucionit dhe në rrjete të tjera sociale.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit</p>	<p>Kërkesat dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të programit të studimit publikohen nëpërmjet fletëpalosjeve dhe guidave, njoftimeve në faqen zyrtare të internetit të universitetit, javëve të informimit, si dhe takimeve të drejtpërdrejta me të interesuarit. Guida që është përfshirë në dokumentacionin që shoqëron RVB nuk e përmban këtë program studimi. Por gjatë vizitës në institucion GVJ iu komunikua se institucioni po përgatiste guidën e re e cila do përfshinte edhe këtë program studimi. Gjithsesi informacioni mbi këtë program studimi është i aksesueshëm në faqen e internetit të institucionit.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<b>X</b>

**Standardi V.2**



<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Rregullorja e njësisë kryesore (Kreu VIII), e njësisë bazë (Kreu III) dhe rregullorja e programit të studimit përcaktojnë qartë kriteret dhe procedurat e përparimit të studentëve për çdo vit akademik. <a href="#">Evidenca 5. Rregullore e FSHE.pdf</a> <a href="#">Evidenca 6. Rregullore e DFBK.pdf</a> <a href="#">Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MPABKF .pdf</a>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Rregullorja e njësisë kryesore (neni 44 dhe 45), përcakton qartë kriteret dhe procedurat që ndiqen për njohjen e kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. <a href="#">Evidenca 5. Rregullore e FSHE.pdf</a>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Programet e lëndëve të hartuara në bazë të rregulloreve të njësisë kryesore dhe bazë, dhe rregullores së programit të studimit përmbajnë kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve në programin e studimit. Nga shqyrtimi i syllabuseve, të gjitha lëndët në këtë program studimi vlerësojnë studentin duke i dhënë maksimumi 10% të pikëve totale nga angazhimi në seminare, 20% nga punimi i detyrës së kursit, 30% nga provimi i ndërmjetëm dhe 40% nga provimi përfundimtar. Ky lloj vlerësimi u konfirmua edhe në takimin me studentët dhe stafin akademik, por GVJ konstatoi se Tabela nr. 15 duhet të saktësohet. <a href="#">Evidenca 5. Rregullore e FSHE.pdf</a> <a href="#">Evidenca 6. Rregullore e DFBK.pdf</a> <a href="#">Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MPABKF .pdf</a> <a href="#">Evidenca 8. Plan mësimor dhe syllabuse MPABKF.pdf</a>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Kreu X i rregullores së FSHE dhe shkurtimisht neni 24 i rregullores së programit të studimit, përcaktojnë procedurat e punimit të diplomës. Sipas nenit 52 të rregullores së FSHE procedurat dhe kriteret e diplomimit duhen të përcaktohen në rreguloren e programit të studimit. Por në rregullore nuk ka asnjë nen lidhur me diplomimin. Udhëzuesi për përgatitjen e diplomës (Evidenca nr. 29) jep udhëzim për punimin e diplomës së ciklit të dyte, por jo në veçanti për MP dhe specifikisht për këtë program studimi. <i>Pavarësisht se studentët këtë vit kanë zgjedhur të zhvillojnë provim formimi, një udhëzues specifik për MPABKF duhet tu vihet në dispozicion studentëve potencialë që kanë dëshirë të mbrojnë diplomën me një punim shkencor.</i> Gjatë vizitës në institucion GVJ iu komunikua se studentëve iu është shpërndarë një plan-organizimi i provimit të formimit dhe do të organizohen konsultime dy javore para datës së zhvillimit të provimit. Ky plan iu vu në dispozicion GVJ me kërkesën e tij gjatë vizitës në institucion (program orientues për provimin përfundimtar). <a href="#">Evidenca 5. Rregullore e FSHE.pdf</a>



	<p>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MPABKF .pdf  Evidenca 29. Udhëzues për përgatitjen e punimit të diplomës.pdf  Evidenca 33. Udhëzues për provimin e formimit.pdf</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>Gjatë vizitës së institucionit, GVJ u informua se në fillim të çdo viti të ri akademik, institucioni zhvillon “Javën e Orientimit”, nëpërmjet të cilës studentët e rinj njihen me programet e studimit, pedagogët, ambjentet dhe disa nga rregullat bazë të universitetit. Zyra e karrierës dhe këshillit studentor organizon takime të vazhdueshme me studentët, harton udhëzues dhe broshura për studimet master me qëllim informimin e të interesuarve për programet e studimit të ofruara nga institucioni.</p> <p>Evidenca 40. Rregullore e ZKKS.pdf</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Niveli i përmbushjes</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<p><b>X</b></p>	

<p><b>Standardi V.3</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve bëhet nga koordinatori i programeve master, pedagogët, sekretaria mësimore dhe ZKSK. Gjithashtu informacioni jepet edhe nëpërmjet faqes së internetit të institucioneve dhe broshurave dhe njoftimeve në ambjentet e institucionit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Departamenti përgjegjës për programin e studimit në bashkëpunim me koordinatorin e masterave vë në dispozicion të studentëve dokumentacionin dhe udhëzuesit për lëndët dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit, duke përfshirë planin mësimor dhe syllabuset. Orën e parë të çdo lënde, pedagogu prezanton studentët me objektivat e lëndës, njohuritë që do të marrin në lëndën përkatëse, literaturën ku do të mbështeten dhe mënyrën e vlerësimit të njohurimeve.</p> <p>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MPABKF .pdf  Evidenca 40. Rregullore e ZKKS.pdf</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni informon si studentët potencialë edhe ata që rregjistrohen mbi mundësitë e punësimit që ofron ky program studimi nëpërmjet ZKKS, departamentit përgjegjës dhe koordinatorit të programeve master. Për këtë qëllim si procedurë organizohen takime me përfaqësues të institucioneve të ndryshme si edhe trainime me studentët për mënyrën se si duhet të aksesojnë në tregun e punës. Por për këtë program studimi takime të tilla nuk janë zhvilluar sepse studentët e këtij program studimi janë të punësuar.</p>



	<u>Evidenca 40. Rregullore e ZKKS.pdf</u>			
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Informacioni lidhur me organizimin dhe zhvillimin e procesit mësimor (sallat e zhvillimit të mësimit, biblioteka, zyrat dhe ambientet ndihmëse, orari mësimor, plani mësimor, ndryshimet e orarit) u komunikohen studentëve nga departamenti përgjegjës në bashkëpunim me koordinatorin dhe ZSKK. Gjithashtu ky informacion ofrohet në stendat e ambienteve të UMSH, si edhe në faqen zyrtare online dhe rrjetet sociale të institucionit.			
<b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë	UMSH ka mundësuar studentëve që informohen lidhur me programin e studimit në çdo kohë dhe në distancë nëpërmjet logimit në sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit i cili është lehtësisht i aksesueshëm nga studentët në çdo kohë dhe distancë.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë*, nga pranimit në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	Në bazë të rregullores së organizimit të UMSH, sekretaria mësimore është përgjegjëse për të ruajtur statistikat e studentëve të regjistruar dhe të diplomuar. Për studentët e programit të studimit MPABKF sekretaria nuk disponon të dhëna mbi punësimin e tyre, meqenëse ky program nuk ka përfunduar dhe nuk ka ende të diplomuar. <u>Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH.pdf</u>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Sipas Tabelës nr.21 bashkëngjitur RVB, në këtë program studimi janë regjistruar 29 studentë gjatë vitit akademik 2021-2022. Nga vizita në institucion rezultoi një student i ç'rrëgjistruar në mars të vitit 2022. Ky ç'rrëgjistrim nuk është paraqitur me Tabelën nr. 21 meqenëse është bërë pas dorëzimit të RVB. <u>Evidenca 10. Përmbledhëse e tabelave për programin MPABKF.pdf</u>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimit, deri në diplomimin e tyre.	Veprimtaria e sekretarisë mësimore rregullohet nga neni nr. 26 i Rregullores së Organizimit të UMSH dhe nga rregullorja e Sekretarisë Mësimore. Sekretaria mësimore ruan dokumentacionin lidhur me të dhënat e studentëve nga momenti i regjistrimit deri në momentin e largimit/diplomimit të tyre: regjistrin themeltar, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistrin e lëshimit të diplomave me shkrim dhe elektronik. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore GVJ u konsultuar me regjistrin themeltar (në të cilin tre studentë rezultojn pa numër matrikullimi) dhe me regjistrin e arritjeve akademike, i cili ishte plotësuar për katër



	lëndët e zhvilluara semestrin e parë. Rregjistri i lëshimit të diplomave nuk është plotësuar meqënëse ky program studimi nuk ka ende të diplomuar. <u>Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH.pdf</u> <u>Evidenca 36. Rregullore e sekretarisë mësimore.pdf</u>			
<b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Sipas RVB të gjitha të dhënat statistikore të studentëve (numri i matrikullimit, nota mesatare në hyrje dhe në dalje, vlerësimi i arritjeve të studentëve dhe të dhëna të tjera personale) ruhen në sistemin e brendshëm të informacionit dhe aksesohen lehtësisht nga personat e autorizuar.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	Meqënëse ky program studimi nuk ka ende të diplomuar, institucioni nuk disponon të dhëna mbi punësimin e studentëve të këtij program studimi dhe nuk ka kryer raporte analitike. Megjithatë nga institucioni GVJ iu konfirmua se institucioni përgatit raporte analitike lidhur me shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, informacion që midis të tjerave e mbledh edhe nëpërmjet një formulari alumni. <u>Evidenca 19. Formular Alumni.pdf</u>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Përfshirja dhe angazhimi zyrtar i studentëve bëhet nëpërmjet organizimit të tyre në Këshillin Studentor. Krijimi i këshillit studentor bëhet sipas nenit 81 të Statutit të UMSH dhe nenit 58 të Rregullores së Organizimit të UMSH. Sipas rregullores, Këshilli studentor zgjidhet cdo dy vjet nga votat e studentëve. Në dokumentacion nuk është përfshirë ndonjë rregullore të Këshillit Studentor (Evidence Nr. 37 e cila raportohet si rregullore e këshillit studentor në RVB nuk ka lidhje me këtë çështje). Gjithashtu në dokumentacionin bashkëngjitur RVB nuk ka donjë evidencë apo praktikë pune të mbledhjeve të këshillit studentor. <u>Evidenca 1. Statuti i UMSH.pdf</u> <u>Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH.pdf</u>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Neni 58 i Rregullores së Organizimit të UMSH u njeh të drejtën studentëve të shprehin mendime dhe propozime lidhur me çështjet që lidhen me aktivitetin mësimor (planet dhe programet e studimit), tarifat e shkollimit, ndarjen e burimeve financiare, veprimtaritë kulturore dhe sportive etj. Nga takimi me studentët e MPABKF, një nga studentët ishte pjesëmarrëse e këshillit studentor. Konkretisht nuk kishte ndonjë



	<p>problem apo propozim specifik nga studentët e këtij program të shprehur prej saj në mbledhjet e këshillit studentor.  <a href="#">Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH.pdf</a></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Ngarkesa e programit të studimit MPABKF është e shpërndarë në mënyrë uniforme gjatë dy semestrave të zhvillimit të procesit mësimor. Sipas planit mësimor, semestrin e parë, studentët ndjekin katër lëndë bazë, ndërsa semestrin e dytë ndjekin një lëndë bazë dhe dy lëndë me zgjedhje nga gjashtë të propozuara, kryejnë praktikën mësimore dy javore dhe punojnë për mbrojtjen e diplomës/provimin e formimit. Nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se plani mësimor i vitit akademik 2021-2022 ka patur një ndryshim: është bërë shkëmbimi i një lënde bazë me një lëndë me zgjedhje, ndryshim që është miratuar nga dekani i FSHE. Njohja e studimeve të plota ose të pjesshme të mëparshme rregullohet me rregulloren e programit të studimit.  <a href="#">Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MPABKF .pdf</a>  <a href="#">Evidenca 10. Përmbledhëse e tabelave për programin MPABKF.pdf</a></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve nëpërmjet nenin 54 të Rregullores së Organizimit të UMSH.</p> <p>Konkretisht, përveç takimeve të vazhdueshme të studentëve me koordinatorin e programit dhe stafin drejtues të njësisë bazë dhe njësisë kryesore, përfshirja e studentëve bëhet nëpërmjet formularit të vlerësimit të lëndës dhe pedagogut (Evidenca Nr. 23) dhe punës me fokus-grupet (Evidenca Nr.25).</p> <p><a href="#">Evidenca 23. Formulari i vlerësimit të lëndës dhe pedagogut nga studenti .pdf</a>  <a href="#">Evidenca 25. Proçedura e punës me fokus-grupet.pdf</a></p>	<p>Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve nëpërmjet nenin 54 të Rregullores së Organizimit të UMSH.</p> <p>Konkretisht, përveç takimeve të vazhdueshme të studentëve me koordinatorin e programit dhe stafin drejtues të njësisë bazë dhe njësisë kryesore, përfshirja e studentëve bëhet nëpërmjet formularit të vlerësimit të lëndës dhe pedagogut (Evidenca Nr. 23) dhe punës me fokus-grupet (Evidenca Nr.25).</p> <p><a href="#">Evidenca 23. Formulari i vlerësimit të lëndës dhe pedagogut nga studenti .pdf</a>  <a href="#">Evidenca 25. Proçedura e punës me fokus-grupet.pdf</a></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Rregullorja e FSHE (neni nr. 42) dhe rregullorja e programit të studimit MPABKF u jep mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës, duke garantuar një proces transparent nga momenti i kryerjes së provimit deri në dhënien e rezultatit përfundimtar. Kjo mundësi u konfirmua edhe nga studentët e pranishëm në takimin me GVJ, megjithëse ata nuk kishin patur ndonjë rast të ndryshimit të vlerësimit të pedagogut.  <a href="#">Evidenca 5. Rregullore e FSHE .pdf</a>  <a href="#">Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MPABKF .pdf</a></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

#### Standardi V.6

**Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
-----------------	-------------------------------



<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Institucioni ka ngritur Zyrën e Këshillimit dhe Karrierës së Studentëve në varësi të Rektorit të UMSH. Neni 36 i Rregullores së Organizimit të UMSH përcakton funksionet dhe detyrat e ZKKS, e cila drejton dhe mbështet studentët gjatë procesit të formimit të tyre universitar dhe i orioneton dhe këshillon ata mbi përfshirjen e tyre në tregun e punës. Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH.pdf</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Objektivat, parimet, detyrat dhe funksionet e Zyres së Karrierës dhe Këshillimit Studentor përcaktohen në rregulloren e saj (Evidenca nr. 40). ZKKS organizon sistemin e tutoriazhit dhe këshillimit akademik që ka për qëllim tu ofrojë asistencë studentëve lidhur me procesin mësimor, formimin akademik, zhvillimin e karrierës dhe me çështje të tjera që kanë të bëjnë me programin e studimit. Evidenca 40. Rregullore e ZKKS.pdf</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët e programit të studimit MPABKF dhe me dy anëtarë dhe kryetarin e zyrës së ZKKS, GVJ iu konfirmua se angazhimi i plotë i ZKKS për të informuar vazhdimisht dhe për të asistuar studentët për çdo problem lidhur me procesin mësimor dhe programin e studimit. Për studentët që ndjekin këtë program studimi orientimi lidhur me praktikën nuk ka qenë i nevojshëm meqenëse studentët janë në marrëdhënie pune dhe praktikën e kanë zhvilluar pranë vendit të tyre të punës.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>Neni nr. 36 i rregullores së Organizimit të UMSH mban të dhënat për të diplomuarit dhe ndjek integrimin e tyre në tregun e punës. Për këtë program studimi nuk ka të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve meqenëse nuk ka ende të diplomuar. Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH.pdf</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht <b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht <b>X</b></p>
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	---

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

57








**Standardi VI.1**

**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore, neni 53 i Statutit të UMSH parashikon ngritjen e Njësisë të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe të Zhvillimit të Kurrukulave, dhe sipas nenit 84 të Statutit të UMSH, institucioni harton politika dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, nëpërmjet të cilit realizohet vlerësimi i veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore të institucionit.</p> <p><u>Evidenca 1. Statuti i UMSH.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Institucioni ka ngritur dhe ka vënë në zbatim Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Manuali i sigurimit të cilësisë përcakton si përgjegjës për sigurimin e cilësisë: Senatin, Rektorin, NJSBCZHK, Dekanin dhe GVB.</p> <p>Sipas Manualit të sigurimit të cilësisë dhe Rregullores së organizimit të UMSH (neni 28) dhe Rregullores së brendshme për organizimin dhe punën e NJSBCZHK (e cila u në dispozicion me kërkesën e GVJ), NJSBCZHK përbëhet nga shtatë anëtare.</p> <p>Sipas Tabelës bashkëngjitur dokumentacionit të RVB, NJSBCZHK përbëhet nga 11 anëtarë.</p> <p>Gjithshtu ka një mospërputhje në dokumentet zyrtare për emërtimin e kësaj njësie: manuali i referohet me termin NJSBC ndërsa rregullorja e organizimit të UMSH i referohet me termin NJSBCZHK. Dokumentacioni i bashkëngjitur RVB nuk përmban dhe vendimin për ngritjen e NJSBC dhe GVB. <i>GVJ sugjeron që ngritja e NJSBCZHK të kryhet sipas kriterëve të përcaktuara në aktet rregullatore të institucionit.</i></p> <p><u>Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH.pdf</u> <u>Evidenca 13. Manuali i NJSBCZHK.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Ky program studimi akreditohet për herë të parë. Institucioni dhe programe të tjera studimi të këtij institucioni i janë nënshtruar proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit. Neni 88 i Statutit dhe neni 79 i Rregullores së organizimit të UMSH, parashikojnë realizimin e procesit të vlerësimit të jashtëm të cilësisë dhe akreditimit institucional dhe të programeve të studimit në përputhje me përcaktimet e Ligjit Nr. 80/2015.</p> <p><u>Evidenca 1. Statuti i UMSH.pdf</u> <u>Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang</p>	<p>UMSH ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, që synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjsteve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit. Në kuadër të ruajtjes së standarteve të cilësisë së veprimtarisë së personelit akademik UMSH organizon trajnime të cilat programohen në</p>





institucional, të njësisve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	fillimit të vitit akademik sipas një plani kalendari të përvitshëm Evidenca 24. Programi i trainimeve 2020-2021.pdf Evidenca 13. Manuali i NJSBCZHK.pdf		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>
			<b>X</b>

### Standardi VI.2

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësisve të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.	Sipas RVB dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ iu konfirmua angazhimi i personelit akademik për shqyrtimin, rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit. Departamenti që është njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit, në bazë të informacionit dhe në bashkëpunim me ZBSCZHK, angazhohet në vlerësimin dhe rishikimin e programeve të studimit. Rregullorja e FSHE (neni 14) i jep Përgjegjësit të Departamentit detyrën për të propozuar në Dëkanat ndryshime të programeve të studimit, të kurrikulave në bazë të nevojave dhe treguesve akademikë. Evidenca 5. Rregullore e FSHE.pdf
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, GVJ konstaton se institucioni përdor disa mekanizma formal të vlerësimit të brendshëm të përcaktuar qartë në rregulloren e UMSH dhe në Manualin e sigurimit të Cilësisë dhe Rregulloren e brendshme për organizimin dhe punën e NJSBCZHK. Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH.pdf Evidenca 13. Manuali i NJSBCZHK.pdf Rregullore e brendshme për organizimin dhe punën e NJSBCZHK.pdf
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	Gjatë vizitës në institucion dhe shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ konstatoi se sigurimi i brendshëm i cilësisë realizohet nëpërmjet instrumenteve të mëposhtme: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Formularit të vetvlerësimit i pedagogut, i cili kontrollohet dhe pikëzohet nga Përgjegjësi i Departamentit dhe Dekani dhe ruhet në dosjen personale të stafit akademik në ZBNJ.</li> <li>• Anketimit dhe formularit të vlerësimit të studentit, nëpërmjet të cilit bëhet vlerësimi i programit të lëndës dhe i pedagogut.</li> <li>• Puna me focus-grupet nëpërmjet të cilëve mbliidhen opinionet dhe reagimet e studentëve lidhur me procesin mësimor, marrëdhëniet me stafin akademik dhe ndihmës akademik dhe çështje të tjera që preokupojnë studentët.</li> <li>• Dëgjesat dhe vëzhgimet në auditor.</li> <li>• Vlerësimi i kualifikimit shkencor të stafit akademik etj.</li> </ul>



	<p>Gjithsesi nga ballafaqimi me studentët u vunë re disa mospërputhje me mënyrën se si realizohej ky proces: p.sh. sipas studentëve vlerësimi i pedagogut dhe i programit të lëndëve bëhej me dy formularë të veçantë, ndërkohë sipas dokumentacionit bashkëngjitur ky vlerësim bëhet nëpërmjet një formulari të vetëm.</p> <p><a href="#">Evidenca 13. Manuali i NJSBCZHK.pdf</a></p> <p><a href="#">Evidenca 23. Formulari i Vleresimit te Pedagogut dhe Lendes nga Studenti.pdf</a></p> <p><a href="#">Rregullore e brendshme për organizimin dhe punën e NJSBCZHK.pdf</a></p> <p><a href="#">Formular vetëvlerësimi stafi i plotësuar.pdf</a></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Informacioni që merret nëpërmjet pyetësorëve të studentëve përpunohet nga zyra e statistikës dhe i kalon për shqyrtim dekanit dhe rektorit, të cilët bëjnë analizën e punës mësimore të stafit akademik. Informacioni që merret nga raporti i vetvlerësimit depozitohet pranë ZBNJ, sipas përfaqësuesit të të cilës në fund të vitit kalendarik pedagogët marrin shpërblim në bazë të vlerësimit të performancës. Statistikat e përpunimit të pyetësorëve, që iu vunë në dispozicion grupit të punës me kërkesë të tij, japin informacion në nivel departamenti, por jo për programin e studimit në veçanti.</p> <p><a href="#">Përpunim i pyetësorëve të studentëve.pdf</a></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë</p>	<p>Për këtë program studimi GVJ nuk disponon ndonjë raport vlerësimi. Sipas manualit të sigurimit të brendshëm të cilësisë, NJSBCZHK përgatit një raport vlerësimi në të cilën evidentohen pikat e forta dhe të dobëta të programeve të studimit dhe propozon sugjerime për përmirësimin e veprimtarisë.</p> <p>Gjatë takimit me anëtarët e NJBSC GVJ nuk iu konfirmua një procedurë e tillë. Sipas tyre plani i masave nuk propozohej nga NJSBCZHK por nga drjetuesi i institucionit/njësisë kryesore dhe njësisë bazë.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<p><b>X</b></p>	


### Standardi VI.3

**Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në</p>	<p>Nga takimi me pedagogët dhe anëtarët e NJSBCZHK GVJ iu konfirmua se në bashkëpunim me departamentet bëhet vlerësimi i programeve të studimit që ofrohen nga secili departament. Rezultatet e marra përfshihen në vetvlerësimin e brendshëm periodik të institucionit.</p>



<p>vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimëve të brendshme periodike.</p>	<p>Institucioni nuk ka paraqitur ndonjë analizë të kësaj pune për këtë program studimi, apo për programe të tjera. Me kërkesë të GVJ, institucioni vuri në dispozicion një Raport pune të NJSBCZHK, por informacioni në të lidhej vetëm mbi dorëzimin dhe formatin e syllabuseve, por nuk përmban ndonjë analizë cilësore mbi programin e studimit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Rregullorja e NJSBCZHK parashikon instrumentet që përdoren nga kjo nëjsi për të gjitha programet e studimit që ofrohen nga institucioni, jo specifikisht për natyrën e programit të studimit. Ky fakt konstatohet edhe nga raporti i vlerësimit të lëndës dhe programit nga studenti, i cili është i unifikuar për të gjitha programet e studimit.</p> <p><u>Rregullore e brendshme për organizimin dhe punën e NJSBCZHK.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 23. Formulari i Vlerësimit të Pedagogut dhe Lëndës nga Studenti.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shteti për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion por edhe nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se institucioni në kuadër të vlerësimit të brendshëm të cilësisë ka për qëllim vlerësimin e programeve të studimit, të kurrikulave, të cilësisë së mësimdhënies, të punës kërkimore-shkencore të stafit akademik, të metodave dhe metodologjisë së vlerësimit, në mirëqeverisjen e Fakultetit dhe në marrëdhëniet e institucionit me jashtë.</p> <p>Nga vizita në institucion dhe dokumentacioni bashkëngjitur RVB, GVJ konstatoi se institucioni përdor tre instrumente për sigurimin e brendshëm të cilësisë: raportin e vetvlerësimit, formularin e vlerësimit nga studentët, vëzhgimet në auditor dhe procedurën fokus-grupe.</p> <p><i>GVJ sugjeron që të formalizojë më mirë instrumentet e përdorur në rregulloret përkatëse, pasi gjatë takimit me studentët pati mospërputhje lidhur me formularët që plotësojnë studentët për vlerësimin e programeve dhe të pedagogët, nga ajo çfarë deklarohet nga institucioni.</i></p> <p><u>Evidenca 13. Manuali i NJSBCZHK.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>Në kuadër të vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit, institucioni përveç pyetësorëve dhe punës me fokus-grupe me studentët aktualë, siguron informacion edhe nga studentët e diplomuar nëpërmjet shpërndarjes së formularëve alumni ku merret informacion jo vetëm mbi elementët e programit të studimit që kanë qenë më të dobishëm për studentët por edhe për mundësinë e tyre për të hyrë dhe përshtatur në tregun e punës.</p> <p>Për këtë program studimi nuk ka student të diplomuar dhe GVJ nuk ka patur në dispozicion ndonjë analizë të këtyre formularëve. GVJ nuk ka në dispozicion ndonjë raport apo dokument mbi praktikën e gjurmimit dhe sondazheve të studentëve alumni, në mënyrë që të gjykojë mbi përdorimin e këtyre instrumentave.</p> <p><u>Evidenca 19. Formulari alumni.pdf</u></p>









Shkalla e përmbushjes së standardit			X	
-------------------------------------	--	--	---	--

**Standardi VI.5**  
**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Rezultatet e punës së NJSBCZHK përfshihen në raportin vjetor të institucionit i cili bëhet publik për studentët dhe të gjithë të interesuarit nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të institucionit.  Linku: <a href="https://umsh.edu.al/625827e15be4d.pdf">625827e15be4d.pdf (umsh.edu.al)</a>			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Institucioni publikon informacionin duke respektuar lirinë dhe etikën akademike si dhe legjislacionin lidhur me ruajtjen e të dhënave personale.			
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Sipas Manuallit dhe nga takimet e zhvilluara, GVJ iu konfirmua që institucioni në bazë të rezultateve të vlerësimit, evidenton pikat e dobëta të programit të studimit dhe harton një plan masash për përmirësimin e tyre. GVJ nuk i është vënë në dispozicion një raport me pikat e dobëta dhe të forta të programit të studimit dhe një plan konkret masash, me arsyetimin se viti akademik për këtë program studimi nuk ka përfunduar.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Personeli akademik u shpreh i gatshëm dhe i hapur që në bazë të rezultateve të vlerësimit të cilësisë, të angazhohet në përmirësimin e programit të studimit.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	NJSBCZHK nëpërmjet mbledhjeve të focus-grupeve informon dhe ndërgjegjëson vazhdimisht studentët për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit dhe inkurajon studentët dhe personelin akademik të angazhohen sa më shumë në këtë proces.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	



**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional “Auditim i Brendshëm dhe Kontroll Financiar” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë”**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. Institucioni ka vendndodhje dhe infrastrukturë të përshtatshme për kryerjen e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore.
2. Programi i studimit paraqet interes për tregun e punës.
3. Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit zotëron gradat shkencore dhe/ose titujt në disiplina që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me lëndët që ata mbulojnë në programin e studimit duke garantuar mbulimin e programeve dhe moduleve mësimore të programit të studimit.



**Pika të dobta**

Lidhur me dokumentacionin që shoqëron RVB, ai është i përgjithshëm dhe sikurse është vënë në dukje edhe në raport mungojnë disa evidenca specifike lidhur me programin e studimit, me arsyetimin se viti akademik nuk është mbyllur dhe nuk janë kryer përpunimet e të dhënave dhe analizat përkatëse. GVJ konstaton pika të dobëta si më poshtë:

1. Hyrja dhe pranimi i studentëve nga programe të tjera vec atyre ekonomike, shpesh i pashoqëruar me përgatitje të fortë në kontabilitet dhe financë. Studentët me formim jo-ekonomik në studimet Bachelor nuk ndjekin kurse shtesë për të marrë njohuritë paraprake që nevojiten për këtë program studimi, ndryshe nga sa specifikohet në aktet rregullatore të institucionit.
2. NJSBC nuk është e organizuar dhe nuk funksionon sipas kritereve të përcaktuara në Statut dhe aktet rregullatore të institucionit.
3. Studimi i tregut i kryer nga institucioni nuk lidhet specifikisht me këtë program studimi.
4. Institucioni nuk ka paraqitur pasqyrat financiare të tre viteve të fundit dhe raportin e audituesit për të evidentuar qëndrueshmërinë financiare të tij.

**Rekomandime**

1. Ndjekja rigoroze e kushteve të pranimit dhe ekuivalentimit të njohurive për studentët që vijnë nga fusha të tjera vec atyre ekonomike.
2. Të rishihen Statuti i UMSH, rregullorja e Organizimit të UMSH dhe Manuali i Brendshëm e Sigurimit të Cilësisë lidhur me numrin e anëtarëve të Njësisë së Sigurimit të Cilësisë dhe të shikohet mundësia e përfshirjes në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë edhe të aktorëve/ekspertëve të jashtëm.
3. Të rishihet mundësia e kryerjes së një studimi të plotë tregu që lidhet drejtpërdrejt me fushën e auditimit të brendshëm dhe kontrollit financiar.
4. Institucioi të tregohet më transparent lidhur me gjendjen dhe raportimin financiar të tij.





5. Faqja zyrtare e internetit të institucionit duhet të përditësohet veçanërisht informacioni që i përket programit të studimit MPABKF. Gjithashtu informacioni nevojitet të jetë i aksesueshëm edhe në një gjuhë tjetër.

## **Conclusions of the Evaluation of the second cycle study program Professional Master's "Internal Audit and Financial Control" offered by the Institution of Higher Education "Mediterranean University of Albania"**

### **Strengths and Affirmations**

1. The institution has a suitable location and infrastructure for carrying out teaching and research/scientific activities.
2. The study program is of interest to the labor market.
3. The academic personnel engaged in the study program possess scientific degrees and/or titles in disciplines that are directly related to the subjects they cover in the study program, guaranteeing the coverage of the programs and teaching modules of the study program.

### **Weakness**

Regarding the documentation that accompanies the SER, it is general and as it was pointed out in the report, some specific evidence related to the study program is missing, on the grounds that the academic year has not been closed and the data processing and relevant analyzes have not been carried out. EEG finds weak points as follows:

1. Entry and acceptance of students from programs other than economics, often not accompanied by strong preparation in accounting and finance. Students with non-economic background in Bachelor studies do not attend additional courses to obtain the prior knowledge needed for this study program, unlike what is specified in the regulatory acts of the institution.
2. Internal Quality Assurance Unit is not organized and does not function according to the criteria defined in the Statute and regulatory acts of the institution.
3. The market research conducted by the institution is not specifically related to this study program.
4. The institution has not submitted the financial statements of the last three years and the auditor's report to evidence its financial stability.


### **Recommendation**

1. EEG recommends a rigorous follow-up of admission conditions and equivalence of knowledge for students coming from fields other than economic ones.
2. It is recommended to review the Statute of MUA, the regulation of the Organization of MUA and the Internal Quality Assurance Manual regarding the number of members of



the Quality Assurance Unit and to consider the possibility of including actors/ external experts in the process of internal quality assurance.

3. To review the possibility of conducting a complete market study that is directly related to the field of the study program.
4. The institution should be more transparent about its financial situation and reporting.
5. The official website of the institution should be updated, especially the information related to the study program. Also, the information needs to be accessible in English language.





**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			X	
VLERËSIMI TËRËSOR				X